



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission



RAPORTI MBI AKTIVITETET E PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË PËR VITIN 2020

01 janar – 31 dhjetor 2020

**Mars 2021
Prishtinë**

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
KORNIZA LIGJORE	5
Baza ekzistuese ligjore që e rregullon Agjencinë	5
PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT (ORGANIZIMI INSTITUCIONAL)	5
Misioni/Vizioni	5
Funksionet e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik sipas ligjit.....	6
Funksioni Ligjor.....	6
Funksioni i monitorimit	6
Funksioni i trajnimeve	6
Funksioni i Revokimit të Certifikatës	7
DEPARTAMENTI I RREGULLAVE	8
DEPARTAMENTI I MONITORIMIT	9
DEPARTAMENTI I TRAJNIMEVE DHE INTEGRIMEVE EUROPIANE.....	11
DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE	13
FUSHËVEPRIMI QË E MBULON INSTITUCIONI	14
BORDI i KRPP-së.....	15
Funksionet e Kryetarit të KRPP-së	15
Funksionet e anëtarit të Bordit.....	16
AKTIVITETET E PROKURIMIT PUBLIK -TË DHËNA STATISTIKORE MBI SISTEMIN E PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË GJATË VITIT 2020	17
Numri i kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020	18
Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020	19
Pjesëmarrja e vlerës së kontratave të nënshkruara në bruto produktin vendor (bpv = 6,661,500,000.00) gjatë vitit 2020	21
Numri total dhe vlera financiare e kontratave vjetore përmes procedurave të prokurimit mbi pragjet financiare të be-së gjatë vitit 2020	22
Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020 sipas burimeve të financimit.....	23
Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020 sipas llojit të prokurimit.....	25
Kontratat e nënshkruara gjatë vitit 2020 sipas vlerës së prokurimit.....	27
Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020 sipas procedurave të prokurimit.....	29
Kontratat e nënshkruara dhe aneks-kontratat gjatë vitit 2020	34
Vlera e kontratave të nënshkruara sipas operatorëve ekonomik vendorë dhe jo-vendorë.....	35
Vlera e kontratave të nënshkruara sipas afatit kohor për publikim gjatë vitit 2020	36
Vlera e kontratave të nënshkruara sipas kriterit për dhënie kontrate gjatë vitit 2020.....	36

Numri mesatar i ofertuesve që kanë konkuruar për një tender gjatë vitit 2020	37
Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë viteve 2015-2020.....	38
Numri dhe vlera e kontratave të nënshkruara nga autoritetet kontraktuese gjatë vitit 2020.....	39
Kontratat e nënshkruara me vlerë mbi 2,000,000.00€ nga autoritetet kontraktuese gjatë vitit 2020	43
AKTIVITETET E KOMISIONIT RREGULLATIV TË PROKURIMIT PUBLIK	45
Aktivitetet e departamentit të rregullave.....	45
Aktivitetet e departamentit të monitorimit.....	49
Aktivitetet e departamentit të trajnimeve dhe integriteteve europiane	55
Aktivitetet e departamentit të TI-së dhe prokurimi elektronik	61
PËRKRAHJA E SISTEMIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË NGA INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE.....	65
REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË	66
KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK.....	72
Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit	72
Raporti financiar	73

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport pasqyron punën e Komisioni Rregullativ të Prokurimit Publik (në vijim “KRPP”) dhe funksionimin e sistemit të prokurimit publik për periudhën nga 1 Janar 2020 deri në 31 Dhjetor 2020. KRPP e ushtron veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Duke u bazuar në Nenin 87.2.13 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, KRPP për çdo vit kalendarik duhet të përgatisë dhe dorëzojë në Qeveri dhe Kuvend një raport vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për atë vit kalendarik, së bashku me rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose përmirësimin e këtij ligji dhe të legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, raport ky që dorëzohet jo më vonë se në fund të Marsit të vitit vijues kalendarik.

Ky raport është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Prokurim Publik, duke paraqitur një analizë mjaft të detajuar mbi të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara në Kosovë, sipas kontratave të nënshkruara publike gjatë periudhës 01 janar - 31 dhjetor 2020.

Përgatitja e këtij raporti përmbush edhe kërkesën e Nenit 87.2.12 të Ligjit për Prokurim Publik, sipas të cilit KRPP-ja duhet t'i grumbullojë, t'i analizojë dhe t'i publikojë informacionet për procedurat e prokurimit publik dhe kontratat e dhëna publike. Pra, raporti paraqet në mënyrë të detajuar edhe të dhëna statistikore në lidhje me funksionimin e sistemit të prokurimit publik në përgjithësi, përfshirë sistemin elektronik të prokurimit.

Edhe gjatë këtij viti KRPP-ja ka përgatitë një raport të tillë, duke u munduar që për çdo vit ta avancojë dhe ta kompletojë atë sa më shumë që të jetë e mundur, me qëllim që Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, ta kenë një pasqyrë të plotë mbi të gjitha aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë të zhvilluara gjatë vitit 2020

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka si qëllim kryesor të veprimtarisë së saj, garantimin e mirëfunksionimit të sistemit të prokurimit publik në Kosovë, duke u fokusuar në drejtimit e mëposhtme:

- Përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor;
- Monitorimi i vazhdueshëm i procedurave të prokurimit të zhvilluara nga autoritetet kontraktuse;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i Sistemit Elektronik të Prokurimit;
- Ngritja e kapaciteteve administrative në fushën e prokurimit në Autoritetet Kontraktore;
- Dhënia e asistencës së vazhdueshme për Autoritetet Kontraktore;
- Rritja e efikasitetit të prokurimit publik.

Ky raport do të jetë mjaft i mirëseardhur edhe për të gjitha institucionet financiare monetare ndërkombëtare që operojnë në Kosovë, sepse do të kenë në dispozicion një raport në të cilin përfshihen aktivitet e prokurimit publik në Kosovë sipas burimeve të financimit, vlerave të kontratave të prokurimit, llojeve të aktiviteteve të prokurimit, si dhe procedurave të prokurimit.

KORNIZA LIGJORE

Baza ekzistuese ligjore që e rregullon Agjencinë

Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik (KRPP) është themeluar në bazë të Pjesës VI të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Sipas nenit 86 të këtij ligji, KRPP-ja është agjenci e pavarur rregullative dhe sipas nenit 87 të këtij ligji është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë dhe i ushtron funksionet që i jepen nga ky ligj.

Me qëllim të funksionimit të mirë, KRPP ka nxjerrë Rregulloren e Punës, e cila ofron një sërë udhëzime operative praktike për menaxhmentin dhe stafin e KRPP-së.

Rregullorja e punës së Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik, është publikuar në ueb-faqen e KRPP-së <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT (ORGANIZIMI INSTITUCIONAL)

Misioni/Vizioni

Misioni i KRPP-së është zhvillimi funksionimi dhe mbikqyrja e përgjithshme e sistemit të prokurimit publik në Kosovë, si dhe zhvillimi, funksionimi dhe mbikqyrja e sistemit elektronik të prokurimit publik në Kosovë (E-Prokurimi).

Si rrjedhojë, misioni i KRPP-së është të nxis respektimin e parimeve themelore të prokurimit lidhur me transparencën, llogaridhënien, konkurrencën e ndershme, trajtim të barabartë dhe vlerën për para duke përmirësuar kapacitetin e sistemit të prokurimit përmes:

- Avancimit të sistemit të monitorimit për zbatimin të kornizës ligjore të prokurimit publik;
- Zhvillimi i burimeve njerëzore, trajnimi dhe arsimi;
- Avancimi i procedurave të menaxhimit të prokurimit publik;
- Rrjedhë më të mirë të komunikimit në mes të të gjithë akterëve të prokurimit publik;
- Prezantimin e objektivave socio-ekonomike dhe mjedisore, në kuadër të politikave të gjelbra dhe të përgjegjshme shoqërore të prokurimit publik;
- Shfrytëzimin e metodave të reja bashkëkohore në zbatimin e ligjit të prokurimit publik si: prokurimit elektronik dhe prokurimi i centralizuar; si dhe
- Ngritjen e vetëdijes së zyrtarëve për funksionimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë.

Funksionet e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik sipas ligjit

Funksionet kryesore të KRPP-së janë të detajuara në Nenin 87 të Ligjit dhe mund të përmbliken si më poshtë:

- Funksioni ligjor
- Funksioni i monitorimit
- Funksioni i trajnimit dhe
- Funksioni i revokimit të certifikatave të prokurimit

Funksioni Ligjor

Departamenti i Rregullave të KRPP-së është përgjegjëse për vendosjen e rregullave dhe kushteve që rregullojnë implementimin e çdo llojit të aktiviteteve të prokurimit publik në Republikën e Kosovës, përfshirë kontratat kornizë. Për më shumë, KRPP është përgjegjëse që të nxjerrë dhe të shpallë masa të hollësishme zbatuese. Masat zbatuese përbëhen nga rregulla, udhëzime, dokumente dhe formular standard të tenderit dhe të kontratës. Të nxjerrë rregulla për autoritetet kontraktuese në lidhje me përdorimin e procedurave të prokurimit elektronik në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe rregulla për menaxhimin e kontratave. Ngjarje iniciuese për intervenime të KRPP-së në Legjislacionin sekondar të Prokurimit Publik do të jenë zbrazëtira dhe mangësi që përsëriten të detektuara dhe dokumentuara gjatë monitorimit të aktiviteteve të prokurimit publik.

Funksioni i monitorimit

Departamenti i monitorimit kryen monitorimin e planifikuar, monitorimin sipas rastit (ad-hoc) të prokurimit dhe monitorimin e njoftimeve.

Funksioni i trajnimeve

Departamenti i trajnimeve të KRPP-së është përgjegjës për hartimin dhe zhvillimin e moduleve trajnuese dhe kurrikulës për kualifikimin e zyrtarëve të prokurimit. Në këtë aspekt Departamenti i Trajnimeve do të shfrytëzojë zbrazëtirat dhe mangësitë e detektuara dhe dokumentet gjatë monitorimit të aktiviteteve të prokurimit publik. Departamenti i Trajnimeve është gjithashtu përgjegjës për të identifikuar trajnerë të përshtatshëm (trajner individë apo organizata të trajnimeve) në prokurimin publik për të ofruar kurset relevante. Departamenti, në bashkëpunim me IKAP-in, duhet të aranzhojë zhvillimin dhe mbajtjen e kurseve profesionale të prokurimit me kohëzgjatje të paktën pesëmbëdhjetë (15) ditë për trajnime bazike dhe dhjetë ditë (10) për trajnime të avancuara dhe do të jetë përgjegjës për organizimin e provimeve. Trajnerët duhet të kenë përvojë në trajnime të prokurimit publik, në praktikat më të mira ndërkombëtare të prokurimit dhe në sistemin e prokurimit të BE-së.

Funksioni i Revokimit të Certifikatës

Revokimi i një certifikate profesionale të prokurimit mund të inicohet nga:

- a. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
- b. Organi Shqyrtues i Prokurimit; ose
- c. Çdo autoritet kontraktues

Kërkesa për revokim të certifikatës duhet të dorëzohet në KRPP dhe duhet të dokumentohet në mënyrë të rregullt. Pas pranimit të kërkesës, KRPP-ja themelon një komision për të shqyrtuar rastin dhe dorëzon kërkesën e tillë dhe dokumentacionin përkatës tek komisioni. Komisioni shqyrton rastin dhe ka të drejtë të kërkojë informacion, sqarime dhe/ose dokumentacion të mëtejshëm nga autoriteti që ka paraqitur kërkesën, në rast se dokumentacioni i paraqitur konsiderohet i pakompletuar apo jo i kënaqshëm. Pas shqyrtimit, komisioni jep mendimin e vet të dokumentuar të Bordi i KRPP-së. Bordi mund të kthejë mendimin e paraqitur tek komisioni në rast se dokumentacioni konsiderohet i pakompletuar apo jo i kënaqshëm. Bordi i KRPP vendos në bazë të kërkesave të përcaktuara në nenin 23 të LPP-së. Në rast se kërkesat e përmendura nuk janë plotësuar, KRPP-ja do të revokojë certifikatën në përputhje me procedurat e përmendura në paragrafin 8 të nenit 25 të LPP-së. Vendimi i Bordit të KRPP-së i komunikohet organit që ka paraqitur kërkesën e revokimit dhe Zyrtarit përkatës të Prokurimit. Nëse mbajtësi i certifikatës nuk është nëpunës civil, personi në fjalë gëzon të drejtën që të njoftohet paraprakisht me shkrim prej nëntëdhjetë (90) ditëve për qëllimin e anulimit të certifikatës së tij/saj. Nëse personi është i pakënaqur me rezultatin, atëherë ai mund të ankojë për anulimin e certifikatës në Gjykatën Themelore – Departamenti për çështje administrative. Nëse mbajtësi i certifikatës është nëpunës civil, autoriteti përkatës do të fillojë procedurat e nevojshme në bazë të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Zyrtari i prokurimit të cilit i është revokuar certifikata mund të fillojë trajnimin bazik të prokurimit publik, pas një periodhe njëvjeçare nga revokimi.

KRPP në strukturën e saj organizative ka gjithësej pesë divizione, katër prej të cilave kryejnë funksionet në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me nenet 25, 81, 87 dhe 88 këtë ligj, si në vijim:

DEPARTAMENTI I RREGULLAVE

Në bazë të nenit 87 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Departamenti i Rregullave kryen funksionet si në vijim:

- Vendosë rregulla të hollësishme për të siguruar zbatimin adekuat të LPP-së nga autoritetet kontraktuese si dhe rregulla për përdorimin dhe ekzekutimin e secilës nga procedurat e përcaktuara në nenet 33-37 të LPP-së; me kusht që, këto rregulla të jenë në përputhje me kërkesat dhe parimet e përcaktuara nga LPP si dhe çfarëdo kërkesë të detyrueshme të BE-së për prokurim;
- Përgatitë dhe shpërndan doracakë të prokurimit, udhëzues, formularë dhe modele standarde për dokumentet e tenderit dhe të kontratave sipas LPP-së në dobi të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik;
- Ofron ndihmë teknike dhe këshilla autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të LPP-së si dhe për çdo dokument që nxirret nga KRPP;
- Nxjerrë dhe publikon interpretime me shkrim të vendimeve administrative për të dyjat, autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji dhe çdo dokumenti të nxjerrë nga KRPP-ja;
- Zhvillon rregullat e detajuara në lidhje me shitjen e aseteve të Autoriteteve Kontraktuese;
- Studion Raportet e monitorimit dhe rekomandimet tjera dhe bashkëpunon ngushtë me Departamentin e Monitorimit, për përmirësimin e rregullave të sistemit të prokurimit publik dhe/ose të ligjit;
- Nxjerrë, pas bashkëpunimit të ngushtë me Departamentin e Teknologjisë së Informacionit, rregulla në lidhje me e-prokurimin, dhe më konkretisht transmisionin elektronik të dokumenteve të tenderit dhe kërkesave për pjesëmarrje dhe pranimin e propozimeve. Këto rregulla duhet të përfshijnë një nënshkrim të avancuar elektronik, në pajtim me standardet ndërkombëtare;

Përveç funksioneve të autorizuara me ligj, Departamenti i Rregullave kryen edhe këto funksione shtesë:

- Mbështetë punën e Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik, duke kryer analiza ligjore gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit dhe legjislacionit dytësor nga autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik;
- Mbikëqyrë pranimin e kërkesave dhe dokumenteve të bashkangjitura të parashtruara nga autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik, vlerëson nëse nevojitet kompletim apo sqarim dhe shqyrton opinionin e mundshëm ligjor në bashkërendim me kryetarin dhe anëtarin e bordit përgjegjës për divizion;
- Cakton dhe mban takime për konsulta, ndihmë teknike dhe këshilla sipas kërkesës së autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik në bashkërendim me kryetarin dhe anëtarin e bordit përgjegjës për divizion;
- Harton opinione, interpretime ligjore dhe këshilla lidhur me rastin që është objekt i kërkesës për interpretim ligjor;

- Siguron shpërndarjen e përgjigjes me shkrim përmes arkivit të KRPP-së pasi që e njëjta të jetë nënshkruar nga eksperti i prokurimit (hartuesi), anëtar i bordit përgjegjës për divizion dhe kryetari i KRPP-së; siguron shpërndarjen e përgjigjes përmes postës elektronike, si dhe në bashkërendim me anëtarin e bordit përgjegjës për divizion dhe kryetarin siguron publikimin në ueb-faqen e KRPP-së nëse për të njëjtën konsiderohet si pyetje e shpeshtë apo si një zgjidhje e problemit të mundshëm të ballafaqimit edhe të autoriteteve tjera kontraktuese;
- Mban takime për: a) Bashkërendim të punëve të Departamentit; b) Diskutim të çështjeve ligjore me kryetarin dhe anëtarin e bordit përgjegjës për divizion lidhur me kërkesat për interpretim të parashtruara nga autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik përmes arkivit të KRPP-së dhe postës elektronike në E-MAIL-in zyrtar info.krpp@rks-gov.net; c) Konsulta me Bordin e KRPP-së, Udhëheqësit e Departamentit të Monitorimit dhe të Departamentit të TI-së lidhur me funksionimin efektiv dhe efikas të KRPP-së për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë.

DEPARTAMENTI I MONITORIMIT

Në bazë të nenit 88 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Departamenti i Monitorimit kryen funksionet si në vijm:

- a. sipas planit;
 - b. sipas rastit; dhe
 - c. duke i përcjellur njoftimet.
- a) Monitorimi i planifikuar i prokurimit
- Përgatit çdo vit një plan të punës për monitorimin e aktiviteteve të prokurimit të identifikuara për monitorim ex-post dhe të menaxhimit të kontratës të autoriteteve kontraktuese të përzgjedhura dhe të njëjtin e dorëzon tek Bordi për miratim;
 - Monitoron aktivitetet e kryera të prokurimit dhe menaxhimit e kontratave aktiviteteve të prokurimit të autoriteteve kontraktuese me qëllim të verifikimit nëse është zbatuar në mënyrë të drejtë LPP, dhe aktet nënligjore, nga inicimi i një aktiviteti të prokurimit deri në realizimin e plotë të kontratës, në përputhje me planin vjetor të punës;
 - Në raste të konstatimit të shkeljeve të ligjit nga ana e autoritetit kontraktues, organizon një takim, me pjesëmarrje të personave përgjegjës për të diskutuar rastin, shpjegojë, sqarojë dhe të elaborojë masa të cilat do të ndërmerren;
 - Dërgon raportet e monitorimeve të planifikuara, te: i. Zyrtari përgjegjës i prokurimit të autoritetit kontraktues përkatës; ii. të organi përkatës për mbikëqyrje (Kryetari i komunës në raste të komunave, Ministri dhe Sekretari Permanent në raste të ministrive përkatëse, Drejtorët/Udhëheqësit më të lartë të ndërmarrjeve publike etj.); dhe iii. në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit në mënyrë që të publikohen në ueb-faqe të internetit të KRPP-së.

b) Monitorimi i prokurimeve sipas rastit

- Kryen monitorim sipas rastit të një aktiviteti të prokurimit në implementim e sipër dhe i përfunduar, përfshirë këtu edhe kohën gjatë realizimit të kontratës, në autoritetet kontraktuese të zgjedhura, bazuar në informacionin e pranuar nga autoritetet kontraktuese, operatorët ekonomik apo palët e treta të pranuar nga KRPP;
- Monitoron ekzistencën dhe kompletimin e dosjes së tenderit para publikimit të njoftimit të kontratës (Kjo dispozitë nuk aplikohet në rast të shfrytëzimit të platformës elektronike);
- Nxjerrë këshilla profesionale në rastet kur konstaton se një aktivitet i prokurimit i autoritetit kontraktues nuk është në përputhje me LPP-në dhe legjislacionin dytësor dhe në veçanti në rastet kur autoriteti kontraktues nuk ka dokumentuar vendimin(et);
- Në raste të konstatimit të shkeljeve të ligjit nga ana e autoritetit kontraktues, organizon një takim, me pjesëmarrje të personave përgjegjës për të diskutuar rastin, shpjegojë, sqarojë dhe të elaborojë masa të cilat do të ndërmerren. Raportet e monitorimeve sipas rastit i dërgon te: i. Zyrtari përgjegjës i prokurimit të autoritetit kontraktues përkatës, ii. Operatori ekonomik, në rast se aplikohet; iii. të organi përkatës për mbikëqyrje (Kryetari i komunës në raste të komunave, Ministri dhe Sekretari Permanent në raste të ministrive përkatëse, Drejtorët/Udhëheqësit më të lartë të ndërmarrjeve publike etj.); dhe iv. në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit në mënyrë që të publikohen në ueb-faqe të KRPP-së.

c) Monitorimi duke i përcjellur njoftimet

- Autoritetet kontraktues njoftojnë KRPP, për rastet në vijim: a) autoriteti kontraktues ka vendosur të përdorë procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë (sipas Nenit 35, paragrafi 1 të LPP-së), b) autoriteti kontraktues ka vendosur të anulojë procedurën e prokurimit për arsye të çmimit abnormalisht të ulët (sipas Nenit 61, paragrafi 5 të LPP-së).
- Monitorojë cilindo nga rastet e përmendura më lart (neni 9.4.3.1), pas vendimit të Udhëheqësit të Departamentit të Monitorimit, duke i ftuar, kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese në fjalë për të rishikuar vendimet e tyre. KRPP-ja duhet të bëjë këtë brenda dy (2) ditë pas marrjes së këtij njoftimi. Sipas nenit 9.4.3.3, nxjerr këshilla profesionale për autoritetin kontraktues, kur KRPP, konstaton se një aktivitet i tillë i autoritetit kontraktues nuk është në përputhje me LPP dhe legjislacionit dytësor dhe në veçanti në rastin kur autoriteti kontraktues nuk e ka arsyetuar (dokumentuar), plotësisht vendimin(et) e tij. Opinionet e KRPP-së të lëshuara në përputhje me paragrafin 9.4.3.1 (a), kanë karakter jodetyrues për autoritetet kontraktuese, por autoritetet kompetente mund t'i marrin ato në konsideratë gjatë trajtimit të ankesave të paraqitura në përputhje me Pjesën IX të këtij ligji.
- Te gjitha njoftimet, sipas mostrave, të dorëzuara në KRPP nga autoritetet kontraktuese kontrollohen gjatë periudhës 2-ditore para publikimit. Gjatë kësaj periudhe Departamenti i Monitorimit nxjerrë rekomandime me shkrim drejtuar Autoritetit kontraktues për korrigjimin e gabimeve ose mangësive. Autoriteti kontraktues do të publikojë dhe qarkullojë korrigjimet;
- Të gjitha njoftimet e dorëzuara në KRPP përmes sistemit të prokurimit elektronik nga autoritetet kontraktuese mund të kontrollohen gjatë periudhës së publikimit deri në hapje. Gjatë kësaj periudhe, Departamenti i Monitorimit mund të nxjerrë rekomandime me shkrim drejtuar

Autoritetit kontraktues për korrigjimin e gabimeve ose mangësive. Autoriteti kontraktues ka përgjegjësi të plotë për të vendosur se si të merr parasysh këto rekomandime;

- Zhvillon dhe miraton metodologjinë e nevojshme dhe manualin për monitorimin e pajtueshmërisë dhe matjen e performancës së Sistemit të Prokurimit Publik në Kosovë dhe përcakton treguesit relevant sasior dhe cilësor për të matur performancën dhe pajtueshmërinë me ligjin të autoriteteve kontraktuese dhe stafit të prokurimit, si dhe për të vlerësuar në tërësi sistemin kombëtar të prokurimit publik;
- Zbaton metodologjinë e mësipërme dhe manualin duke zhvilluar një plan të punës; duke vazhduar me mbledhjen e të dhënave në terren përmes pyetësorëve ose metodave të tjera; vendosjen e të dhënave në një bazë të dhënave për analiza; vlerësimin e vlerave të indikatorëve ose informacione të tjera relevante cilësore; raportimin e të gjitha gjetjeve tek Bordi i KRPP-së në baza të rregullta dhe integrimin e tyre në raportet e KRPP-së; mbështetja e çdo veprimi që rrjedh nga gjetjet e performancës dhe të pajtueshmërisë;
- Përgatitë dhe elaboron raportet vjetore të pajtueshmërisë dhe performancës që identifikojnë përparësitë dhe mangësitë në implementimin e Ligjit, në sistemin e prokurimit publik dhe implementimin e aktiviteteve të kontratave. Raportet do t'i paraqiten Bordit të KRPP-së për hapat e mëtejshëm në përgatitjen e një strategjie për të rritur performancën e zbatimit të sistemit të prokurimit publik, si dhe rekomandimet për përmirësim;
- Elaboron dhe dorëzon tek Departamenti i rregullave, Departamenti i trajnimeve dhe Integritimeve Evropiane çdo rekomandim për përmirësim në sistemin dhe/ose Ligjin e prokurimit publik, me theksim të veçantë në aktivitetet e prokurimit.

DEPARTAMENTI I TRAJNIMEVE DHE INTEGRIMEVE EUROPIANE

Në bazë të nenit 25 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Departamenti i trajnimeve dhe Integritimeve Evropiane kryen funksionet si në vijim:

- Zhvillon module të trajnimit dhe kurrikulës për kualifikimet në prokurim për trajnimin Themelor dhe të Avansuar (Nivelin Qendror dhe Lokal, OE, OJQ) duke përgatitë katalogun, programet, modulet për trajnime, të cilat aprovohen nga Bordi i KRPP –së;
- Harton një listë të dokumentuar të kualifikimeve për certifikim si trajnerë dhe si pjesëmarrës në trajnimet e prokurimit. Lista e kualifikimeve publikohet në ueb-faqen e KRPP-së;
- Identifikon personat, me përvojë në prokurimin publik, të përshtatshëm për mësimdhënie në kurset e prokurimit të hartuara nga KRPP-ja për Trajnim Themelor dhe të Avansuar;
- Siguron që trajnerët e përzgjedhur të jenë persona të certifikuar për trajnim dhe të jenë të trajnuar nga një institucion i trajnimeve që ka ekspertizë substanciale në praktikatat më të mira ndërkombëtare të prokurimit dhe në sistemin e prokurimit të BE-së.
- Përzgjedh dhe Ripërtërin Listën e trajnerëve për çdo 5 vite nga Komisioni i Përcaktuar nga Kryetari i KRPP-së;
- Propozon angazhimin e trajnerëve nga Lista e trajnerëve për programe të trajnimit Themelor dhe të Avancuar për çdo vit në Bordin e KRPP-se;

- Në bashkëpunim me IKAP-in, aranzhon zhvillimin dhe mbajtjen e kurseve profesionale të prokurimit me kohëzgjatje të paktën pesëmbëdhjetë (15) ditë për trajnime bazike dhe dhjetë ditë (10) për trajnime të avancuara sipas Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të KRPP- IKAP;
- Në bashkëpunim me IKAP-in, është përgjegjëse për organizimin e provimeve në mbështetje të Rregullores për procedurat e zhvillimit të testeve në programet e trajnimit për Prokurim Publik;
- Në bashkëpunim me IKAP-in, lëshon “certifikatën themelore profesionale të prokurimit” vetëm për personat të cilët i kanë përfunduar në mënyrë të kënaqshme të gjitha kurset themelore dhe të cilët rekomandohen nga Komisioni i vlerësimit të testeve;
- Në bashkëpunim me IKAP-in, lëshon “certifikatën e avancuar profesionale të prokurimit” vetëm për personat të cilët i kanë përfunduar në mënyrë të kënaqshme të gjitha kurset e avancuara dhe të cilët rekomandohen nga Komisioni i vlerësimit të testeve;
- Përkrahë IKAP-in dhe autoritetet tjera publike për edukim dhe trajnim për të implementuar trajnime të nivelit të lartë për zyrtarët e prokurimit dhe profesionistëve të tjerë të prokurimit, që synojnë në implementimin e praktikave të mirëfillta të prokurimit dhe të respektimit të Ligjit;
- Është përgjegjëse për elaborimin e moduleve të trajnimit mbi Prokurimin Publik dhe përtirjen e tyre, sipas nevojave të trajnimit dhe ndryshimeve në Ligjin e Prokurimit Publik dhe legjislacionin dytësor;
- Zbaton analiza periodike të nevojave për trajnime për zyrtarët e prokurimit publik në Kosovë, operatorët ekonomik dhe për stafin e KRPP-së, në mënyrë që të definojnë nevojat e tyre për trajnime;
- Mirëmban dhe përtërinë databazat e Autoriteteve Kontraktuese (AK-të), zyrtarëve të certifikuar të prokurimit dhe trajnerëve të certifikuar në prokurim publik;
- Përforcon vetëdijen në mesin e autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik për legjislacionin e prokurimit publik si dhe objektivat, procedurat dhe metodat.

Përveç funksioneve të autorizuar me ligj, Departamenti i trajnimeve dhe Integriteteve Evropiane kryen edhe këto funksione shtesë:

- Ofron mbështetje për pjesëmarrjen e KRPP-së në aktivitetet e procesit të integrimit evropian dhe koordinon të gjitha aktivitetet e nevojshme të kërkuara nga KRPP-ja;
- Monitoron dhe raporton për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian në lidhje me prokurimin publik në Kosovë dhe harmonizimin e legjislacionit përkatës me acquis të BE-së;
- Bashkëpunon me MF dhe MIE rreth Planit Kombëtar për zbatimin e MSA-së (PKZMSA) dhe raporton në baza tre mujore rreth këtij plani;
- Koordinon asistencën e IPA-së dhe ndihma të tjera të huaja për aktivitetet e KRPP-së dhe siguron që kanë të bëjnë me prioritetet e KRPP-së dhe sistemit të prokurimit publik të Kosovës;

DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

Në bazë të nenit 87 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Departamenti i Teknologjisë Informative kryen funksionet si në vijim:

- Mirëmban dhe është përgjegjës për administrimin e platformës së prokurimit elektronik dhe të gjitha komponentët e nevojshme hardëare dhe softëare;
- Është përgjegjës për zbatimin e politikave, procedurave dhe rregulloreve për sigurinë e TI-së; administrimin e aplikacionit; administrimin e bazës së të dhënave; planifikimin e vazhdimësisë së biznesit; planin e menaxhimit/veprimit të rrezikut; planifikimi nga ri-mëkëmbja prej fatkeqësive; politika e kopjes rezervë (Back-up); politika arkivore;
- Mirëmban Regjistrin Elektronik të Prokurimit Publik, si pjesë të platformës së prokurimit elektronik, që do të shërbejë si arkiv për kopje elektronike të të gjitha njoftimeve, ftesave, deklaratave, dosjeve të tenderit, raporteve, ankesave dhe vendimeve të arkivuara apo të lëshuara në lidhje me secilin aktivitet të prokurimit të performuar apo të inicuar nga një autoritet kontraktues;
- Mbështet zhvillimin e sistemit elektronik për monitorimin e respektimit të LPP, nga autoritetet kontraktuese, përfshirë përgatitjen e formularëve të raportimit që do të plotësohen nga të gjitha autoritetet kontraktuese që i nënshtrohen ligjit;
- Mbështet zhvillimin e metodave elektronike të prokurimit, të tilla si e-prokurimi, ankandin elektronik dhe sistemin dinamik të blerjes, në përputhje me dispozitat e LPP-së;
- Mbështet prezantimin dhe përdorimin, nga të gjitha palët e përfshira, të nënshkrimit elektronik, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Përveç platformës së prokurimit elektronik, kryen edhe funksionet tjera:

- Ofron mbështetjen e nevojshme për sistemet tjera të TI të KRPP-së;
- Siguron funksionimin e sistemeve të TI të KRPP-së dhe për zhvillimin, integrimin, pajtueshmërinë dhe sigurinë e infrastrukturës së TI të KRPP;
- Mirëmban faqen e internetit të KRPP, duke i siguruar publikut qasje të pa kufizuar në: a) Ligj dhe tërë legjislacionin sekondar të lëshuar nën autoritetin e Ligjit, b) çdo interpretim dhe dokumente, c) të gjitha informacionet që përmbahen në Regjistrin e Prokurimit Publik d) të gjitha raportet e përgatitura nga Departamenti për Monitorim, si rezultat i procedurave të monitorimit.
- Siguron këshilla dhe udhëzime të detajuara për të gjithë stafin që përdorin sistemin e TI në lidhje me dispozitat e sigurisë së TI. Këto dispozita duhet të zbatohen nga i gjithë stafi i KRPP-së, që përdorin sistemin e TI;
- Mbështet zbatimin e Politikave dhe Procedurave të Sigurisë së KRPP-së. I gjithë personeli duhet të informohet në lidhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave dhe Politikat dhe Procedurat e mësipërme, nga legjislacioni i ASHI-së, KRPP-së dhe institucionet tjera, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe duhet t'i zbatojnë ato;

- Sektori i tavolinës ndihmëse i përgjigjet kërkesave për ndihmë teknike me anë të telefonit, dhe në mënyrë elektronike të gjitha Autoriteteve Kontraktuese dhe Operatorëve Ekonomik, dhe i këshillon mbi veprimin e duhur që të ndjekin procedurat standarde;
- Përcjell problemet që mund të shfaqen për të korrigjuar platformën dhe identifikon situata që kërkojnë vëmendje urgjente;
- Publikon njoftimet e pranuar nga Departamenti i Monitorimit, pasi që njoftimet të kenë kaluar procedurën e kontrollimit nga Departamenti i Monitorimit. (Kjo dispozitë nuk aplikohet për shfrytëzuesit e platformës elektronike).

FUSHËVEPRIMI QË E MBULON INSTITUCIONI

KRPP-ja ka katërdhjetë e dy (42) pozita të aprovuara prej të cilave tre (3) janë Funksionar Publik (Bordi i KRPP-se) .

Numri i të punësuarve aktual ne KRPP duke përfshi edhe Bordin është tridhjetë e gjashtë (36), derisa gjashtë (6) vende të punës janë të pa plotësuar.

Ne baze të LPP-se mandati i Bordit të KRPP-se është pesë (5) vjeçar , dy anëtarët e Bordit të KRPP-së janë emëruar me vendimin e datës 03.08.2015 ndërsa Kryetari me vendimin e datës 02.11.2018 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Organogrami i KRPP-se është bashkangjitur në këtë raport si ANEX I

BORDI i KRPP-së

Bordi i KRPP-së, është institucioni më i lartë për marrjen e vendimeve kolektive të KRPP-së. Kryetari gjithmonë është njëri nga anëtarët. Vetëm Bordi do t'i ketë të drejtat si në vijim:

- Të aprovojë aktet dytësore dhe çdo amendament tjetër;
- Të aprovojë dhe dorëzojë në Qeveri dhe Kuvend raportin vjetor të punës, jo më vonë se në fund të muajit mars të vitit kalendarik të radhës, që analizon aktivitetet e prokurimit në Kosovë që ndodhin gjatë atij viti kalendarik dhe që bënë rekomandime për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose ligjit aktual;
- Të aprovojë strategjitë dhe planet tjera të KRPP-së;
- Të nxjerrë udhëzime për trajtimin e dokumenteve;

Bordi i KRPP-së është përgjegjës për të organizuar dhe menaxhuar punën e divizioneve përkatëse dhe për implementimin e funksioneve apo aktiviteteve tjera të përcaktuara nga Kryetari. Bordi i KRPP-së siguron mbështetjen teknike dhe administrative për funksionimin efektiv dhe efikas të Divizioneve. Anëtarët e Bordit të KRPP-së, janë emëruar sipas nenit 89 të LPP, dhe mund të largohen ose suspendohen vetëm sipas nenit 93 të LPP.

Funksionet e Kryetarit të KRPP-së

- Kryetari përfaqëson, menaxhon dhe organizon punën e KRPP-së dhe ka përgjegjësinë e përgjithshme për performancën e punëve ditore;
- Përgjegjësia për të kryer funksionet dhe aktivitetet e KRPP-së të cilat nuk janë përcaktuar apo përfshirë në ndonjë Divizion bie mbi Kryetarin;
- Kryetari ka autoritetin që të caktojë cilindo anëtar të stafit për të organizuar dhe menaxhuar punën e KRPP-së në fusha të caktuara, në veçanti funksione specifike apo aktivitete të cilat nuk janë të përfshira në funksionet apo aktivitetet e Divizionit të KRPP-së. Kryetari ka për të informuar anëtarët e Bordit për ndonjë përcaktim të tillë. Një kopje e dokumentit në lidhje me delegimin e përgjegjësisë do t'i bartet Menaxherit të personelit, i cili do të kujdeset për dosjen dhe t'i përfshijë ato përgjegjësi të deleguara herë pas here. Kryetari mund t'i ndryshojë këto përgjegjësi ashtu siç ai/ ajo i sheh të arsyeshme;
- Kryetari do të thërret takimet e Bordit të KRPP-së, kur dhe si ai konsideron të jetë e nevojshme apo kur kërkohet nga dy anëtarët e tjerë të KRPP-së;
- Kryetari do të udhëheq takimet e Bordit të KRPP-së. Në raste të jashtëzakonshme kur është e nevojshme që KRPP, të ketë një takim në mungesë të Kryetarit, ai duhet të autorizojë një nga anëtarët tjerë të Bordit të KRPP-së për të udhëhequr takimin;
- Aprovon listën e vendeve të punës;
- Aprovon përshkrimin e vendeve të punës;
- Përcakton detyrat e nëpunësve të KRPP-së;

- Shkarkon nënpunësit;
- Ka përgjegjësi për menaxhimin e fondeve financiare të KRPP-së;
- Përcakton një anëtarë tjetër për të prezantuar, menaxhuar, dhe organizuar punën e KRPP në mungesë të Kryetarit p.sh të ushtrojë detyrën e Kryetarit. Ky person mund të ndryshojë prej një mungese në tjetrën;
- Jep udhëzime duke siguruar qarkullimin e dokumenteve brenda KRPP;
- Konkludon dhe nënshkruan marrëveshje dhe kontrata të nevojshme për të kryer funksionet e KRPP-së;
- Nënshkruan dokumentet në emër të KRPP-së, nënshkruan të gjitha vendimet e arritura nga Bordi. Asnjë dokument zyrtar nuk duhet të lëshohet nga KRPP, i cili nuk është nënshkruar nga Kryetari, përveç komunikimeve elektronike;
- Siguron se Rregullat e Procedurave Financiare të Ministrisë së Financave (MF) janë zbatuar nga secili punëtorë i KRPP-së, në fushat e tyre funksionale;
- Monitoron dhe kontrollon shpenzimet e KRPP-së;
- Siguron se të gjithë nënpunësit të cilët kanë përgjegjësi për administrimin financiar janë të këshilluar në mënyrën e duhur;
- Siguron se ekziston një ndarje e qartë e detyrave në mes administrimit të financave dhe kontrollit adekuat.

Funksionet e anëtarit të Bordit

- Anëtari i Bordit merr përsipër përgjegjësinë e Departamentit nën përgjegjësinë e tij në të gjitha fushat e funksionimit të tij, duke përfshirë, ndër të tjera, çështjet organizative, punën dhe produktet e punës;
- Propozon përshkrimet e vendeve të punës për Udhëheqësin e Departamentit;
- Cakton detyrat për Udhëheqësin e Departamentit;
- Nënshkruan dokumentet e lëshuara nga Departamenti. Asnjë dokument zyrtar nuk duhet të lëshohet nga Departamenti, i cili nuk është nënshkruar nga anëtari i Bordit, përveç komunikimeve elektronike.

AKTIVITETET E PROKURIMIT PUBLIK -TË DHËNA STATISTIKORE MBI SISTEMIN E PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË GJATË VITIT 2020

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) për çdo vit kalendarik duhet të përgatisë dhe dorëzojë në Qeveri dhe Kuvend një raport vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për atë vit kalendarik. Gjatë vitit 2020 në Kosovë janë evidentuar 158 autoritete kontraktuese që kanë kryer prokurime, ndërsa për 16 autoritete kontraktuese prokurimet i ka kryer Agjencioni Qendror i Prokurimit.

Përmes raporteve vjetore mbi kontratat e nënshkruara publike, të cilat autoritetet kontraktuese gjatë janarit të vitit 2021, i kanë dërguar në mënyrë elektronike pranë Departamentit të monitorimit, ky divizion pra i ka pranuar dhe ka kontrolluar këto raporte të dërguara nga autoritetet kontraktuese.

Bazuar në raportet e dërguara nga autoritetet kontraktuese, shihet se gjatë vitit 2020 në tërë Kosovën janë nënshkruar 10935 kontrata publike të udhëhequra sipas Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, duke i përfshirë të gjitha llojet e vlerave të kontratave.

Në vazhdim të raportit do t'i paraqesim prokurimet publike në Kosovë sipas kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020. Duke pasur për bazë raportet e viteve paraprake, të përgatitura nga KRPP-ja sipas kërkesave të LPP-së, raporti në vijim paraqet aktivitetet e prokurimit, pra të gjitha kontratat e nënshkruara nga autoritetet kontraktuese, duke bërë një analizë të kontratave të nënshkruara sipas burimeve të financimit, llojit të autoriteteve kontraktuese, sipas llojit të kontratave, vlerës së kontratave, procedurave të përdorura, aneks kontratave, operatorëve ekonomikë të shpërblyer me kontratë, afateve kohore të publikimit dhe kritereve të shpërblimit me kontratë.

Pra, raporti në vazhdim i pasqyron të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara gjatë vitit 2020 në Kosovë, duke i analizuar dhe duke i krahasuar me vitet paraprake, me ç'rast do ta shohim trendin e zhvillimit të Prokurimit Publik në Kosovë.

NUMRI I KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2020


NUMRI I KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA				
Autoritetet kontraktuese	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020 ¹
Qeveritare	7452	9074	9216	8039
Kompani publike	2751	3335	3225	2888
Tjera/OJQ	11	3	20	8
Gjithësej	10015	10214	12412	10935

Tabela 1

Duke u bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës, autoritetet kontraktuese janë të obliguara t'i paraqesin të gjitha kontratat e nënshkruara, duke përfshirë edhe ato me vlerë minimale.

Analiza e kontratave të nënshkruara fillohet me ndarjen e autoriteteve kontraktuese në organizata buxhetore – Qeveritare, Kompani publike dhe të Tjera-OJQ. Duke u bazuar në këtë ndarje, në *Tabelen 1 dhe Grafikonin Nr.1* pasqyrohet numri i kontratave të nënshkruara gjatë katër viteve të fundit nga autoritetet kontraktuese në fjalë.

¹ Në numrin e kontratave të nënshkruara janë përfshirë edhe 272 aneks kontrata dhe 4115 kontrata me vlerë minimale (deri në 1000 Euro)



Grafikoni 1


VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2020

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA (€)				
Autoritetet kontraktuese	Vlera e kontratave 2017	Vlera e kontratave 2018	Vlera e kontratave 2019	Vlera e kontratave 2020 ²
Qeveritare	354,478,891.29	533,708,962.76	648,915,705.35	430,545,294.42
Kompani publike	103,084,640.60	97,519,718.76	129,081,829.61	63,841,131.20
Tjera/OJQ	2,226,414.05	394,004.50	3,398,500.08	4,925,480.97
Gjithsej	459,789,945.94	631,622,686.02	781,396,035.04	499,311,906.59

Tabela 2

² Në vlerën e kontratave të nënshkruara është përfshirë edhe vlera e aneks kontratave në vlerë prej **4,993,109.65€**


Në bazë të klasifikimit të autoriteteve kontraktuese, si më lartë në tabelën nr. 2 dhe grafikun nr. 2, pasqyrohet vlera e kontratave të nënshkruara, gjatë katër viteve të fundit.



Grafikoni 2

Grafikoni nr.3 e pasqyron strukturën, apo pjesëmarrjen e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020. Organizatat buxhetore - Qeveritare marrin pjesë me 86.23%, Kompanitë publike me 12.78%, derisa të autoritetet Tjera – OJQ - të me vetëm 0.99% në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara.


Struktura e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020



Grafikoni 3

PJESËMARRJA E VLERËS SË KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA NË BRUTO PRODUKTIN VENDOR (BPV³ = 6,661,500,000.00) GJATË VITIT 2020

PJESËMARRJA E VLERËS SË KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA NË BRUTO PRODUKTIN VENDOR GJATË VITIT 2020



Grafikoni 4

³ Burimi: Ministria e Integrimit Evropian

**NUMRI TOTAL DHE VLERA FINANCIARE E KONTRATAVE VJETORE PËRMES
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT MBI PRAGJET FINANCIARE TË BE-SË
GJATË VITIT 2020**


NUMRI TOTAL DHE VLERA FINANCIARE E KONTRATAVE VJETORE PËRMES PROCEDURAVE TË PROKURIMIT MBI PRAGJET FINANCIARE TË BE-SË (€)		
Lloji i kontratave:	Vlera e kontratave	Numri i kontratave
Furnizime: <i>(Mbi 144,000.00)</i>	151,242,200.16	214
Shërbime: <i>(Mbi 144,000.00)</i>	38,149,620.83	90
Konkurs i projektimit: <i>(Mbi 144,000.00)</i>	0.00	0
Punë: <i>(Mbi 5,548,000.00)</i>	20,966,575.09	3
Gjithsejt:	210,358,396.08	307

Tabela 3

VLERA E KONTRATAVE TË NËSHKRUARA GJATË VITIT 2020 SIPAS BURIMEVE TË FINANCIMIT

VLERA E KONTRATAVE TË NËSHKRUARA SIPAS BURIMEVE TË FINANCIMIT (€)				
Burimet e financimit	Vlera e kontratave 2017	Vlera e kontratave 2018	Vlera e kontratave 2019	Vlera e kontratave 2020
Të hyrat vetanake⁴	97,873,515.49	134,266,540.98	129,081,829.61	64,561,429.20
Buxheti i Kosovës	351,580,882.16	496,962,140.54	648,915,705.35	429,706,444.42
Donacione	10,335,548.29	394,004.50	3,398,500.08	5,044,032.97
Gjithsej	459,789,945.94	631,622,686.02	781,396,035.04	499,311,906.59

Tabela 4




Grafikoni 4

Në tabelën nr. 4 dhe grafikonin nr. 4 është pasqyruar vlera e kontratave të nënshkruara, duke pasur për bazë burimin e financimit. Nga të hyrat vetanake vlera e kontratave të nënshkruara

⁴ Të hyrat vetanake paraqesin të hyrat e Kompanive Publike.

gjatë vitit 2020 është 64,561,429.20€. Nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës vlera e kontratave të nënshkruara arrin 429,706,444.42€, derisa nga donacionet vlera e kontratave të nënshkruara arrin 5,044,032.97€.



Grafikoni 5

Struktura e vlerës së kontratave të nënshkruara sipas burimeve të financimit pasqyrohet në grafikonin nr.5 ku të Hyrat vetanake të kompanive marrin pjesë me 12.93%, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës me 86.06%, kurse nga donacionet me 1.01%.


VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2020 SIPAS LLOJIT TË PROKURIMIT

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS LLOJIT TË PROKURIMIT (€)				
Lloji i prokurimit	Vlera e kontratave 2017	Vlera e kontratave 2018	Vlera e kontratave 2019	Vlera e kontratave 2020
Furnizim	159,713,785.04	181,870,671.15	235,430,873.96	221,932,503.76
Shërbime⁵	55,688,897.04	92,320,204.14	111,247,767.38	66,894,988.70
Konkurs i projektimit	886,142.00	554,212.40	648,304.00	516,320.00
Punë	243,501,121.86	356,877,598.33	434,069,089.70	209,968,094.13
Gjithësej	459,789,945.94	631,622,686.02	781,396,035.04	499,311,906.59

Tabela 5


Bazuar në llojin e prokurimit, që kontratat kanë si objekt të tyre, në tabelën nr. 5 dhe grafikonin nr. 6, vlera e kontratave të nënshkruara për furnizime gjatë vitit 2020 arrin në 221,932,503.76€. Vlera e kontratave të nënshkruara për shërbime është 66,894,988.70€, dhe vlera e kontratave të nënshkruara për konkurs projektimi është 516,320.00€. Ndërsa vlera e kontratave të nënshkruara për punë arrin në 209,968,094.13€.

⁵ Në vlerën e kontratave për shërbime janë përfshirë edhe shërbimet e konsulencës.



Grafikoni 6

Grafikoni nr 7, paraqet strukturën, apo pjesëmarrjen e kontratave të nënshkruara, sipas vlerës në totalin e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020.



Grafikoni 7


Kontratrat për furnizime marrin pjesë me 44.45%, kontratat për shërbime me 13.40%, kontratat për konkurs të projektimit me 0.10%, ndërsa kontratat për punë marrin pjesë me 42.05%.

KONTRATAT E NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2020 SIPAS VLERËS SË PROKURIMIT

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS VLERËS SË PROKURIMIT (€)				
Lloji i vlerës së prokurimit	Vlera e kontratave 2017	Vlera e kontratave 2018	Vlera e kontratave 2019	Vlera e kontratave 2020
Vlerë e madhe	275,854,900.58	443,215,634.22	553,935,201.43	318,971,649.46
Vlerë e mesme	170,092,960.74	172,588,576.84	210,746,301.72	168,442,815.46
Vlerë e vogël	11,003,741.55	11,746,993.37	12,885,351.93	8,831,940.16
Vlerë minimale	2,838,343.07	4,071,481.59	3,829,179.96	3,065,501.51
Gjithsej :	459,789,945.94	631,622,686.02	781,396,035.04	499,311,906.59


Tabela 6

Kontratrat e nënshkruara, të ndara sipas llojit të vlerave të kontratave në tabelën nr. 5 dhe në grafikonin nr.9, na pasqyrojnë se, sipas vlerës së madhe, vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020 është 318,971,649.46€.



Grafikoni 9

Kontratave të nënshkruara me vlerë të mesme arrijnë shumën prej 168,442,815.46€, vlera e kontratave të nënshkruara me vlerë të vogël është 8,831,940.16€, derisa vlera e kontratave të nënshkruara me vlerë minimale është 3,065,501.51€.



Grafikoni 10

Në bazë të *grafikonit nr.10*, vërehet se pjesëmarrja e kontratave me vlera të mëdha, në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020, është 63.88%. Kontratave me vlera të mesme marrin pjesë në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara me 33.73%. Kontratave me vlerë të vogël marrin pjesë në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara me 1.77%, derisa kontratat me vlerë minimale marrin pjesë me 0.62%.

**VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2020 SIPAS
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT**


VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS PROCEDURAVE TË PROKURIMIT (€)				
Lloji i procedurave:	Vlera e kontratave 2017	Vlera e kontratave 2018	Vlera e kontratave 2019	Vlera e kontratave 2020
Procedurë e hapur	400,232,896.14	559,457,758.80	690,524,312.30	430,276,184.21
Procedurë e kufizuar	3,443,042.82	3,835,107.58	4,917,179.96	367,591.00
Konkurs projektimi	713,569.56	439,267.14	977,714.20	630,661.80
Procedurë konkurruese me negociata	0.00	0.00	330,247.46	0.00
E negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës	42,164,760.65	51,658,934.60	68,443,389.16	56,807,918.29
Kuotimi i çmimeve	10,398,703.61	12,123,641.88	12,356,308.94	7,601,746.25
Procedurë për vlerë minimale	2,836,973.16	4,107,976.02	3,846,883.02	3,627,805.04
Gjithsejt :	459,789,945.94	631,622,686.02	781,396,035.04	499,311,906.59

Tabela 7


Analiza e kontratave të nënshkruara, të ndara sipas llojit të procedurave në tabelën nr.7 dhe në grafikun nr.11, tregon se vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës së hapur gjatë vitit 2020 është **430,276,184.21€**, derisa sipas procedurës së kufizuar gjatë vitit 2020 është **367,591.00€**.

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës konkurs projektimi, gjatë vitit 2020, është 630,661.80€, Kurse sipas procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës është 56,807,918.29€ dhe vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës kuotim i çmimeve, gjatë vitit 2020, është **7,601,746.25€**.

Ndërkaq, sipas procedurës për vlerë minimale, vlera e kontratave të nënshkruara, gjatë vitit 2020, është **3,627,805.04€**.



Grafikoni 11




Grafikoni 12

Analiza e strukturës, apo e pjesëmarrjes së procedurave të zbatuara gjatë vitit 2020, në grafikonin nr. 12, na tregon se pjesëmarrja e procedurës së hapur në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara është 86.17%, e cila është nga procedurat e përdorura më së shumti dhe e njohur si procedura më transparente.

Gjithashtu edhe pjesëmarrja e procedurës së negociuar pas publikimit të njoftimit të kontratës është 11.38%.


Pjesëmarrja e procedurave sipas kuotimit të çmimeve është 1.52% dhe sipas vlerës minimale merr pjesë me 0.73%, e kufizuar 0.07%, kurse konkurset e projektimit marrin pjesë vetëm me 0.13% në vlerën e kontratave të gjithëmbarshme të nënshkruara gjatë vitit 2020.

Në grafikonin 12.a me qellim të analizave me detale është paraqitur vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit për kontratë (duke mos përfshirë kontratat për **punë shtesë**), pra puna shtesë nuk janë përfshirë (ato janë trajtuar si procedure e hapur meqë rrjedhin nga një aktivitet i procedurave të hapura). Andaj pjesëmarrja e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës (pa përfshirë kontrata shtesë) gjatë vitit 2020 është **10.38%**.



Grafikoni 12.a


Qeveritare: Pjesëmarrja e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020 sipas procedurave



Grafikoni 13


Grafikoni 13 pasqyron përdorimin e procedurave të prokurimit të organizatat buxhetore apo Qeveritare. Derisa grafikoni 14 pasqyron përdorimin e procedurave të prokurimit të Kompanitë Publike dhe grafikoni 15 paraqet përdorimin e procedurave të prokurimit të organizatat tjera- OJQ-të.

Kompani publike : Pjesëmarrja e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020 sipas procedurave



Grafikoni 14

Tjera/OJQ : Pjesëmarrja e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020 sipas procedurave



Grafikoni 15


KONTRATAT E NËNSHKRUARA DHE ANEKS-KONTRATAT GJATË VITIT 2020

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA DHE ANEKS-KONTRATAVE GJATË VITIT 2017,2018 DHE 2019 (€)

Kontratat:	Vlera 2018(€)	Pjesëmarrja 2018 %	Vlera 2019(€)	Pjesëmarrja 2019 (%)	Vlera 2020(€)	Pjesëmarrja 2020 (%)
Kontratrat e nënshkruara	622,272,616.48	98.52	768,308,004.26	98.33	494,318,796.94	99.00
Aneks - kontratat	9,350,069.54	1.48	13,088,030.78	1.67	4,993,109.65	1.00
Gjithsej	631,622,686.02	100.00	781,396,035.04	100.00	499,311,906.59	100.00

Tabela 8

Struktura e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020 dhe aneks kontratave



Grafikoni 16

Siç shihet nga tabela e mësipërme nr.8 dhe grafikoni nr.16, vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020 është 494,318,796.94€, me një pjesëmarrje prej 99.00% në vlerën e gjithëmbarshme të kontratave të nënshkruara e që është 499,311,109.59€, kurse vlera e aneks kontratave arrin në 4,993,109.65€, apo me pjesëmarrje 1.00% në vlerën e gjithëmbarshme të kontratave të nënshkruara e që është 499,311,109.59€.

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS OPERATORËVE EKONOMIK VENDORË DHE JO-VENDORË


Nga analiza e bërë vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020, të ndara sipas shpërblimit me kontratë në operatorë ekonomik **Vendor**, pjesëmarrja në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara është 98.39%. Derisa operatorët **Jo-Vendor** pjesëmarrja në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara është 1.61%.

STRUKTURA E VLERËS SË KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2020 SIPAS OPERATORËVE EKONOMIK VENDORË - JO-VENDOR

Operatorët Ekonomik:	Numri i kontratave:	Vlera e kontratave:	Pjesëmarrja %
OE: Vendor	10827	491,262,218.88	98.39
OE: Jo-Vendor	108	8,049,687.71	1.61
Gjithësejt :	10935	499,311,906.59	100.00

Tabela 9

Struktura e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020 sipas Operatorve Ekonomik Vendorë - Jo Vendor



Grafikoni 17

**VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS AFATIT KOHOR PËR
PUBLIKIM GJATË VITIT 2020**

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS AFATIT KOHOR TË PUBLIKIMIT GJATË VITIT 2018, 2019 DHE 2020 (€)						
Afatet e publikimit	Vlera e kontratave 2018	Pjesëmarrja %	Vlera e kontratave 2019	Pjesëmarrja %	Vlera e kontratave 2020	Pjesëmarrja %
Afate normale kohore	577,511,949.92	91.43	673,828,876.64	86.23	418,231,797.84	83.76
Shkurtim i afatit	54,110,736.10	8.57	107,567,158.40	13.77	81,080,108.75	16.24
Gjithsej	631,622,686.02	100.00	781,396,035.04	100.00	499,311,906.59	100.00

Tabela 10

Të dhënat në tabelën nr.10, vlera e kontratave të nënshkruara nga autoritetet kontraktuese me afate normale kohore të publikuara është 418,231,797.84€ dhe me pjesëmarrje prej 83.76% në vlerën e gjithëmbarshme të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020. Kurse vlera e kontratave të nënshkruara të publikuara me afat të shkurtuar arrin në 81,080,108.75€, gjegjësisht me pjesëmarrje prej 16.24 % në numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020.

**VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS KRITERIT PËR DHËNIE
KONTRATE GJATË VITIT 2020**

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS KRITERIT PËR DHËNIE GJATË VITIT 2018,2019 DHE 2020(€)						
Kriteret për dhënie kontrate	Vlera e kontratave 2018	Pjesëmarrja (%)	Vlera e kontratave 2019	Pjesëmarrja (%)	Vlera e kontratave 2020	Pjesëmarrja (%)
Çmimi më i ulët	625,401,425.24	99.02	775,304,750.28	99.22	497,442,294.26	99.63
Çmimi ekonomikisht më i favorshëm	6,221,260.78	0.98	6,091,284.76	0.78	1,869,612.33	0.37
Gjithsej :	631,622,686.02	100.00	781,396,035.04	100.00	499,311,906.59	100.00


Tabela 11

Siç shihet në tabelën nr. 11 vlera e kontratave të nënshkruara nga autoritetet kontraktuese, sipas kriterit për dhënie çmimi më i ulët, është 497,442,294.26€, me pjesëmarrje prej 99.63% në vlerën e gjithëmbarshme të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020. Ndërkaq, vlera e kontratave të nënshkruara sipas kriterit për dhënie çmimi ekonomikisht më të favorshëm arrin në 1,869,612.33€, gjegjësisht me pjesëmarrje prej 0.37 % në numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020, gjithnjë duke u bazuar në raportet e AK.

NUMRI MESATAR I OFERTUESVE QË KANË KONKURUAR PËR NJË TENDER GJATË VITIT 2020


Grafikoni nr. 18 na pasqyron numrin mesatar të ofertuesve që kanë konkuruar për një tender apo prokurim në Kosovë gjatë viteve 2016 deri 2020. Gjatë vitit 2020 mesatarja e ofertave për një aktivitet të prokurimit në procedurë të hapur ka qenë **4.8 oferta**, derisa mesatarja gjatë viteve 2016-2020 rezulton të jetë 4.7 oferta.

Numri mesatar i OE që kan konkuruar për një tender gjatë viteve 2016 - 2020



Grafikoni 18

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITEVE 2015-2020



Grafikoni 19

Grafikoni nr. 19 na paraqet diagramin e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë viteve 2015 deri 2020.

**NUMRI DHE VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA NË KOSOVË NGA
AUTORITETET KONTRAKTUESE GJATË VITIT 2020**

NR	AUTORITETET KONTRAKTUESE	NR. i KONT.	VLERA E KONT. (€)	PJESËMARR-JA (%)
1	Administrata Tatimore e Kosovë	40	3,936,229.72	0.79
2	Agjencia e Menaxhimit Emergjent	21	2,112,333.52	0.42
3	Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës	42	1,604,609.63	0.32
4	Agjencia e Statistikave të Kosovës	17	329,064.48	0.07
5	Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale	3	8,866.80	0.00
6	Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror	22	395,980.64	0.08
7	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	29	478,612.98	0.10
8	Agjencia Kadastrale e Kosovës	9	30,532.31	0.01
9	Agjencia Kosovare e Privatizimit	30	790,242.87	0.16
10	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	35	712,741.07	0.14
11	Agjencia Pyjore e Kosovës	15	389,829.28	0.08
12	Agjencia Qendrore e Prokurimit (Prokurimet për AK)	76	1,568,087.63	0.31
13	Agjencia Qendrore e Prokurimit	26	37,088,201.09	7.43
14	Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës	20	60,169.05	0.01
15	Akademia e Kosovës për Siguri Publike	20	1,768,390.93	0.35
16	Akademija e Shkencave dhe e Arteve të Kosoves	26	62,245.22	0.01
17	Biblioteka Kombetare e Kosoves	59	146,644.11	0.03
18	Community Development Initiatives	8	4,925,480.97	0.99
19	Dogana e Kosovë	59	1,166,970.53	0.23
20	Fondi i Sigurimit Shendetesor	10	52,389.42	0.01
21	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës	18	118,786.88	0.02
22	Hortikultura Sh.a. Prishtinë	35	104,239.15	0.02
23	Infrakos SH.A	65	69,542.77	0.01
24	Inspektorati Policor i Kosovës	17	181,652.46	0.04
25	Institucioni i Avokatit të Popullit	22	41,358.67	0.01
26	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës	39	1,158,493.48	0.23
27	Këshilli Prokurorial i Kosovës	33	1,404,624.68	0.28
28	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	47	200,609.71	0.04
29	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	45	271,448.78	0.05
30	Kompania per Menaxhimin e Deponive ne Kosove	27	743,974.59	0.15
31	Komuna Junik	39	5,057,903.42	1.01
32	Komuna Kline	61	2,631,417.70	0.53
33	Komuna Zubin Potoku	26	969,944.05	0.19
34	Komuna Dragash	231	€ 3,893,851.52	0.78
35	Komuna e Deçanit	61	4,068,287.22	0.81
36	Komuna e Drenasit	136	6,773,948.25	1.36
37	Komuna e Fushë Kosovës	103	5,303,427.72	1.06
38	Komuna e Gjakovës	250	9,618,586.44	1.93
39	Komuna e Gjilanit	102	3,194,059.03	0.64
40	Komuna e Graçanicës	76	2,985,144.19	0.60
41	Komuna e Istogut	160	5,970,416.70	1.20
42	Komuna e Kamenices	126	2,945,598.60	0.59
43	Komuna e Lypjanit	214	7,098,339.33	1.42

44	Komuna e Mamushës	35	582,049.51	0.12
45	Komuna e Novobërdës	44	616,013.65	0.12
46	Komuna e Obiliqit	108	5,911,219.86	1.18
47	Komuna e Pejës	172	14,947,550.51	2.99
48	Komuna e Podujevës	179	8,043,181.43	1.61
49	Komuna e Prishtinës	317	20,333,691.91	4.07
50	Komuna e Prizrenit	374	15,240,117.96	3.05
51	Komuna e Rahovecit	96	6,659,669.92	1.33
52	Komuna e Vitisë	76	4,114,216.18	0.82
53	Komuna Ferizaj	137	17,011,017.06	3.41
54	Komuna Hani i Elezit	92	1,301,696.69	0.26
55	Komuna Kaçanik	126	2,167,136.77	0.43
56	Komuna Klllokot	9	235,969.03	0.05
57	Komuna Leposavic	52	5,727,192.49	1.15
58	Komuna Malisheve	213	5,486,943.42	1.10
59	Komuna Mitrovica e Veriu	77	2,957,186.64	0.59
60	Komuna Mitrovicë	50	3,395,413.86	0.68
61	Komuna Partesh	25	253,596.89	0.05
62	Komuna Ranilug	53	601,612.78	0.12
63	Komuna Shtërpçë	38	1,430,374.64	0.29
64	Komuna Shtime	123	2,665,276.33	0.53
65	Komuna Skenderaj	163	3,965,067.07	0.79
66	Komuna Suharekë	178	4,636,299.67	0.93
67	Komuna Vushtrri	196	2,929,267.82	0.59
68	Komuna Zvečan	53	1,278,855.71	0.26
69	Korporata Energjetike e Kosovës	684	36,385,051.66	7.29
70	KOSTT SH.A	227	3,239,862.58	0.65
71	KRM Çabrat sh.a. Gjakovë	16	125,232.74	0.03
72	KRM EKOREGJIONI SH.A. -PRIZREN	82	336,006.65	0.07
73	KRM PASTËRTIA SH.A. FERIZAJ	19	488,341.22	0.10
74	KRM Pastrimi Prishtinë	106	2,154,890.21	0.43
75	KRM Uniteti Sh.A - Mitrovicë	55	447,810.60	0.09
76	KRU "BIFURKACIONI" SHA - FERIZAJ	33	84,664.67	0.02
77	KRU Ambienti Peje	99	540,764.59	0.11
78	KRU Drini i Bardhë- Pejë	7	13,393.30	0.00
79	KRU HIDRODRINI SH.A.	27	837,673.91	0.17
80	KRU Hidromorava sh a Gjilan	85	1,189,061.32	0.24
81	KRU Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren	52	439,979.89	0.09
82	KUR Mitrovica Sh.A.	18	168,293.04	0.03
83	KUR Prishtina Sh a	64	1,629,489.11	0.33
84	KRU Radoniqi&Dukagjini sha	27	99,334.30	0.02
85	KRU,,Gjakova" Sh.a Gjakovë	62	801,437.57	0.16
86	Kuvendi i Republikës së Kosovës	32	398,629.10	0.08
87	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	51	20,623,667.56	4.13
88	Ministria e Bujqësis Pylltaris. dhe Zhvillimit Rural	13	87,589.75	0.02
89	Ministria e Drejtësisë	8	1,229,360.16	0.25
90	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	7	3,003,314.79	0.60
91	Ministria e Financave	27	411,243.92	0.08
92	Ministria e Infrastruktues	23	15,234,414.59	3.05
93	Ministria e Integrimit Evropian	2	28,500.14	0.01
94	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	46	1,721,667.41	0.34
95	Ministria e Mbrojtjes	64	7,128,302.91	1.43
96	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit	44	1,419,498.30	0.28

97	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	30	615,112.48	0.12
98	Ministria e Punëve të Brendshme	89	8,485,871.06	1.70
99	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporë	17	164,992.88	0.03
100	Ministria e Pushtetit Lokal	12	121,721.48	0.02
101	Ministria e Shendetësisë	111	15,486,505.74	3.10
102	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	46	362,876.09	0.07
103	Ministria për Komunitete dhe Kthim	20	4,225,653.74	0.85
104	Ministria e Zhvillimit Rajonal	24	45,463.51	0.01
105	N.P.L. PALLATI I RINISË SH a	41	94,200.30	0.02
106	Ndërmarrja Publike Banësore Sh.A	44	1,196,136.75	0.24
107	NH Ibër Lepenc sh.a	37	1,425,934.86	0.29
108	NP Ngrohtorja e Qytetit Gjakove	4	2,872.00	0.00
109	Ngrohtorja e qytetit Termokos Sh.A.	52	581,486.42	0.12
110	NPL. PASTRIMI SH. A H. Elezit	23	29,266.22	0.01
111	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	2	1,750.49	0.00
112	Policia e Kosovës	72	5,004,065.23	1.00
113	Posta e Kosovës Sh.A.	43	960,100.88	0.19
114	Qendra e Mjekësisë Urgjente	7	12,594.35	0.00
115	Qendra e Shëndetit Mendor - Pejë	24	38,340.28	0.01
116	Qendra e Shëndetit Mendor dhe SHIB Prizren	36	76,124.94	0.02
117	Qendra e shendetit mendor dhe SHIB-Mitrovicë	12	15,006.81	0.00
118	Qendra e Shendetit Mendor Gjakove	11	24,837.53	0.00
119	Qendra e Shëndetit Mendor Prishtinë	14	43,662.16	0.01
120	Qendra e Studenteve	40	1,363,943.06	0.27
121	Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës	22	241,662.15	0.05
122	Qendra Klinike Universitare e Kosoves	436	11,517,520.49	2.31
123	Qendra Kombetare e Kosoves per Transfuzionin e Gjakut	19	1,966,302.84	0.39
124	Qendra Kombetare e Mjekesise Se Punes Kosoves-Gjakove	20	107,955.78	0.02
125	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare- Prishtinë	44	114,815.29	0.02
126	Qendra Multifunkionale Sh.A	14	66,974.27	0.01
127	Qendra per Integrimin dhe Rehabilitimin e të Semureve Kronik Psikatrik - Shtime	5	4,629.00	0.00
128	Qendra Shendetesore Mentale Hareja	1	4,950.00	0.00
129	Radio Televizioni I Kosovës	37	327,452.45	0.07
130	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës	30	952,187.32	0.19
131	Sherbimi i Shendetit Mendor - GJILAN	26	41,708.60	0.01
132	Sherbimi i Shendetit Mendor-Ferizaj	4	3,615.00	0.00
133	Shërbimi Korrektues i Kosovës	58	3,223,602.51	0.65
134	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	308	61,112,049.03	12.24
135	Spitali i Përgjithshëm- Ferizaj	23	21,961.00	0.00
136	Spitali i Pergjithshem Gjakove	52	989,953.18	0.20
137	Spitali i Pergjithshem Gjilan	36	1,349,847.78	0.27
138	Spitali i Përgjithshëm Mitrovicë	54	470,515.98	0.09
139	Spitali i Pergjithshem Peje	68	1,133,688.04	0.23
140	Spitali i Pergjithshem Prizren	60	1,366,978.11	0.27
141	Spitali Vushtrri	69	469,721.52	0.09
142	Stacioni i autobusave Gjakov	5	4,807.92	0.00
143	Stacioni i autobusave Peje	3	2,110.13	0.00
144	Stacioni i Autobusëve Sh.A Prishtinë	34	63,406.54	0.01
145	Telekomi i Kosoves Sh a	39	577,114.52	0.12
146	TRAFIKU URBAN SH.A Prishtine	51	1,316,118.89	0.26
147	Trainkos Sh.a	60	297,451.62	0.06
148	Trepça Sh a	169	3,794,534.33	0.76

149	Trepça-Ndërmarrje në Administrim të AKP-së – Zvečan	520	4,340,520.54	0.87
150	Universiteti Ukshin Hoti Prizren	25	735,150.13	0.15
151	Universiteti Haxhi Zeka Peje	57	1,457,594.96	0.29
152	Universiteti i Mitrovicës - Isa Boletini	41	686,562.80	0.14
153	Universiteti i Gjakovës-Fehmi Agani	41	334,049.59	0.07
154	Universiteti i Prishtinës - Hasan Prishtina	51	3,307,426.76	0.66
155	Universiteti Publik - Kadri Zeka Gjilan	40	555,351.85	0.11
156	Zyra e Kryeministrit	39	422,053.30	0.08
157	Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës	32	136,850.88	0.03
158	Zyra Kombëtare e Auditimit	65	222,820.85	0.04
	Gjithësej:	10935⁶	499,311,906.59	100

⁶ Në numrin e kontratave të nënshkruara janë përfshirë edhe 272 aneks kontrata dhe 4115 kontrata me vlerë minimale (deri në 1000 Euro)

**KONTRATAT E NËNSHKRUARA ME VLERË MBI 2,000,000.00€ NGA
AUTORITETET KONTRAKTUESE GJATË VITIT 2020**

NR	AUTORITETET KONTRAKTUESE:	PROCEDURA E PËRDORUR	PËRSHKRIMI I KONTRATËS	VLERA E KONTRATËS (€)
1	Agjencia Qendrore e Prokurimit	Procedurë e Hapur	Furnizim me Karburante Lot 1- Nivel lokal	9,506,381.41
2	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	E negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës	Furnizim me libra për vitin shkollor 2020-2022	8,791,424.61
3	Ministria e Infrastruktures	Procedurë e Hapur	Lot 1-Rikonstruimi i rrugës Rajonale R115,Segmenti Prizren-Prevall Km 0+00.00 - Km.16+00.00 L=16,000 km	7,849,716.18
4	Ministria e Infrastruktures	Procedurë e Hapur	Lot 2-Rikonstruimi i rrugës Rajonale R115,Segmenti Prizren-Prevall Km.16+00.00 - Km.26+00.00 L=10,000 km	6,643,867.79
5	Korporata Energjetike e Kosovës	E negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës	Demontimi , blerja dhe montimi i zbarave të statorit si dhe komisionimi gjeneratorëve G1dhe G2 në TC Kosova B	6,472,991.12
6	Agjencia Qendrore e Prokurimit	Procedurë e Hapur	Furnizim me IT	5,400,000.00
7	Agjencia Qendrore e Prokurimit	Procedurë e Hapur	Furnizim me Karburante Lot 2- Nivel lokal	5,076,294.69
8	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	Procedurë e Hapur	Ndërtimi i Objektit Spitalor për Nënë dhe Fëmijën në Prizren	4,915,029.40
9	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	Procedurë e Hapur	Shërbimet e pastrimit dhe sanitarisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës-Ritender	4,808,609.28
10	Korporata Energjetike e Kosovës	Procedurë e Hapur	Furnizim me shirit transportues gomë-pëlhurë	4,482,903.07
11	Komuna Junik	Procedurë e Hapur	Ndërtimi i rrugës Junik- Gjeravicë	4,416,859.77
12	Agjencia Qendrore e Prokurimit	Procedurë e Hapur	Furnizim me Karburante Lot 6- Nivel lokal	4,331,855.75
13	Komuna Leposavic	Procedurë e Hapur	Rekonstrukcija rečnih korita, potpornih zidova, mostova i lokalnih puteva u opštini Leposavić	4,293,828.00
14	Komuna Ferizaj	Procedurë e Hapur	Bashkimi I qytetit-projekt dy vjeçar	4,030,290.00

15	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	Procedurë e Hapur	Shërbimet e pastrimit dhe sanitarisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës-Ritender Lot 11	3,855,276.00
16	Ministria për Komunitete dhe Kthim	Procedurë e Hapur	Ndertimi dhe renovimi i shtepive për të kthyerit dhe komunitetet në nevojë	3,786,499.52
17	Agjencia Qendrore e Prokurimit	Procedurë e Hapur	Furnizim me Peme dhe Perime	3,000,000.00
18	Agjencia Qendrore e Prokurimit	Procedurë e Hapur	Furnizim me Karburante Lot 4- Nivel lokal	2,869,485.92
19	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	Procedurë e Hapur	Blerja e pajisjeve për mbrojtjen e objekteve arsimore për qendrueshmeri dhe blerja e pakove të nevojshme për fusha lëndore dhe mirëmbajtje	2,850,309.00
20	Korporata Energjetike e Kosovës	Procedurë e Hapur	Remonti kapital i kaldajës për bllokun A4	2,736,140.34
21	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	Procedurë e Hapur	Shërbimet e pastrimit dhe sanitarisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës-Ritender Lot 3	2,722,368.00
22	Komuna Ferizaj	Procedurë e Hapur	Rikonstruimi i rrugës :Varosh-Gërllicë-	2,654,328.96
23	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	Procedurë e Hapur	Shërbimet e pastrimit dhe sanitarisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës-Ritender Lot 1	2,470,490.40
24	Administrata Tatimore e Kosovë	Procedurë e Hapur	Furnizimi me infrastrukturë hardverike (Blade Server, Storage) për sistemin e ri informativ sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së	2,433,573.20
25	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	Procedurë e Hapur	Shërbimet e pastrimit dhe sanitarisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës-Ritender Lot 4	2,248,000.00
26	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	Procedurë e Hapur	Shërbimet e pastrimit dhe sanitarisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës-Ritender Lot 2	2,227,230.00
27	Agjencia Qendrore e Prokurimit	Procedurë e Hapur	Furnizim me Buke dhe brumra kategoria 5 Lot 2	2,180,838.60
28	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	Procedurë e Hapur	Shërbimet e pastrimit dhe sanitarisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës-Ritender Lot 8	2,134,080.00
29	Agjencia Qendrore e Prokurimit	Procedurë e Hapur	Furnizim me Karburante Lot 3- Nivel lokal	2,059,998.37

AKTIVITETET E KOMISIONIT RREGULLATIV TË PROKURIMIT PUBLIK

AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË RREGULLAVE

Bazuar në paragrafin 2.3 dhe 2.8 të nenit 87 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Kosovë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Departamenti i Rregullave për Prokurim Publik (*këtu e në vijim "DRR"*) përpiloi "Raportin Vjetor", i cili pasqyron punën një vjeçare të këtij departamenti.

Në përputhje me LPP-në dhe legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, DRR pranë KRPP-së e ushtron veprimatrinë e vet duke u fokusuar kryesisht në (i) hartimin e akteve dytësore, rregullave dhe udhëzimeve, si dhe formularëve Standard për unifikimin e praktikave në fushën e prokurimit publik dhe harmonizimin me direktivat e BE-së, (ii) dhënien e opinioneve, këshillave apo udhëzimeve dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji dhe legjislacionit dytësor sipas kërkesave të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik, (iii) në dhënien e propozimeve për plotësim/ndryshim të LPP-së dhe/ose legjislacionit dytësor me qëllim të funksionalizimit të platformës elektronike për prokurimin publik.

Qëllimi kryesor i Departamentit të Rregullave krahas funksionimit dhe avancimit të sistemit të prokurimit publik në Kosovë është ngritja e shkallës së përgjegjësisë së autoriteteve kontraktuese të cilat financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, si dhe sigurimi i mënyrës më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike dhe burimeve publike në Kosovë, në mënyrë që të minimizojë në masë të konsiderueshme mundësinë e keqmenaxhimit të fondeve publike.

Për këtë qëllim, Departamenti i Rregullave në bazë të nenit 87 të Ligjit për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, ka autorizimin dhe përgjegjësinë që të:

- përgatitë dhe të publikojë rregulla të hollësishme për prokurimin publik të cilat kanë për qëllim implementimin e këtij ligji nga autoritetet kontraktuese, duke përfshirë rregullat për përdorimin dhe ushtrimin e secilës procedurë të prokurimit të përcaktuar në nenet 33-37 të këtij ligji;
- amandamentojë rregullat e aprovuara (nëse është e nevojshme);
- bashkëpunojë me departamentet e tjera të KRPP-së;
- përgatitë dhe publikojë doracakë (manuale) për prokurim, udhëzues, formularë standard dhe modele të kontratave në ndihmë të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik;
- ndihmojë dhe këshillojë autoritetet kontraktuese të Kosovës, ndërmarrjet publike dhe operatorët ekonomik për zbatimin e drejtë të dispozitave të këtij ligji dhe legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP;

- të ngritë vetëdijen e autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik mbi legjislacionin e prokurimit publik, si dhe objektivat, procedurat dhe metodat e përcaktuara në këtë legjislacion;
- Të nxjerrë dhe publikojë interpretime administrative me shkrim për autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik lidhur me zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji dhe të rregullave të prokurimit publik;
- Vënia e kontakteve, inicimi dhe themelimi i bashkëpunimit me gjykata, prokurori, Agjencinë Kundër Korrupsion, Zyrën Kombëtare të Auditimit, Organin Shqyrtues të Prokurimit, Agjencinë Qendrore të Prokurimit dhe institucionet tjera në Kosovë;
- Vënia e kontakteve, inicimi dhe themelimi i bashkëpunimit me institucionet homologe në shtetet e regjionit e më gjerë me qëllim të themelimit të bashkëpunimit, këmbimit të përvojave dhe avancimit të çështjeve në fushën e prokurimit;
- Kontrollimi analitik i kohëpaskohshëm me qëllim të verifikimit të realizimit të objektivave të parapara.

Që nga fillimi i vitit 2020 e deri në përfundimin e tij, Departamenti i Rregullave ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në përpilimin dhe publikimin e interpretimeve në ueb-faqen e KRPP-së për problemet e ndeshura gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit publik nëpërmes Platformës elektronike të prokurimit publik, dhënien e përgjigjeve me shkrim në bazë të kërkesave me shkrim të palëve të interesuara përmes arkivit të KRPP-së dhe adresës zyrtare elektronike “rregullat.krpp”, si dhe dhënien e këshillave për prokurimin publik autoriteteve kontraktuese, operatorëve ekonomik dhe palëve tjera të interesuara qoftë përmes telefonit ashtu edhe përmes konsultave në zyrën e DRR pranë KRPP-së.

Në bazë të kërkesave me shkrim nga autoritetet kontraktuese dhe Operatorët Ekonomik për të njëjtat pyetje, gjatë vitit 2020 janë nxjerrë dhe publikuar në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik, në linkun “Informacione” tek “Pyetjet e shpeshta”, 10 interpretime ligjore, që deri më tani në total arrijnë numrin në gjithësej 80 interpretime ligjore. (Përgjigje në pyetjet e parashtruara).

Që nga dt. 30.10.2009, kur Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, për herë të parë themeloi “tavolinën ndihmëse” me qëllim të ofrimit të këshillave profesionale, interpretime të dispozitave të ligjit dhe të legjislacionit dytësor, me kërkesë të autoriteteve kontraktuese, operatorëve ekonomik, si dhe palëve tjera të interesuara çdo ditë pune në tel. + 381 (0) 38 213 709, si dhe në e-mail: info.krpp@ks-gov.net, deri më tani, është vlerësuar të funksionojë mjaft mirë, sepse me angazhimin maksimal, efikasitetin dhe shkathtësinë e ekspertëve të prokurimit të Departamentit të Rregullave që nga 1 Janari e deri më 31 Dhjetor të vitit 2020, kanë arrit të ofrojnë në total **Dymijë e tetëmbëdhjetë (2.018)** këshilla/interpretime përmes arkivit të KRPP-së, adresës zyrtare (elektronike) “rregullat.krpp”, drejtpërdrejtë si dhe përmes telefonit, si në vijim:

Përgjigjet e dhëna nga Departamenti i Rregullave pranë KRPP-së për Autoritetet Kontraktuese dhe operatorët ekonomik gjatë periudhës 1 Janar – 31 Dhjetor 2019

NR	Mënyra e dhënies së përgjigjeve	Përgjigjet e dhëna në numër	Përgjigjet e dhëna për autoritetet kontraktuese	Përgjigjet e dhëna për operatorët ekonomik
01	Interpretime me shkrim (përmes arkivit të KRPP-së)	26	15	11
02	Interpretime përmes adresës elektronike të KRPP-së	743	386	357
03	Interpretime përmes telefonit zyrtar të KRPP-së	1,168	797	371
04	Takime-Konsulta	81	54	27
05	Totali i përgjigjeve për AK-të dhe OE-të	2,018	1.252	766

Edhe gjatë vitit 2020, Departamenti i Rregullave ka pasur një bashkëpunim të ngushtë me institucionet tjera, veçanërisht me Agjencinë Kundër Korrupsion, Agjencinë Qendrore të Prokurimit, Organin e Shqyrtimit të Prokurimit, Zyrën Kombëtare të Auditimit, Njësitë për hetimin e Krimeve Ekonomike, si dhe me OJQ-të.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, nga Departamenti i Rregullave janë dhënë sqarime, këshilla dhe interpretime me shkrim qoftë përmes arkivit të KRPP-së ashtu edhe përmes E-MAIL-it zyrtar të këtij departamenti info.krpp@rks-gov.net me qëllim të zbatimit të drejtë të dispozitave të këtij ligji dhe legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj.

Gjatë vitit 2020, me qëllim zbatimin e drejtë të dispozitave të këtij ligji dhe legjislacionit dytësor, Departamenti i Rregullave ndihmoi në zbatimin e drejtë të dispozitave të LPP-së dhe legjislacionit dytësor:

- Agjencinë Kundër Korrupsion në 15 raste të hetimit;
- Agjencinë Qendrore të Prokurimit në 5 raste aktiviteteve të prokurimit;
- Organin e Shqyrtimit të Prokurimit në 2 raste të shqyrtimit të aktiviteteve të prokurimit;
- Njësinë për Hetimin e Krimeve Ekonomike në 14 raste të hetimit të aktiviteteve të prokurimit; dhe
- Zyrën Kombëtare të Auditimit në 2 raste të auditimit të AK-ve dhe në 3 raste të ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit.

Në përputhje me nenin 84 **“Marrëveshjet për shërbime të veçanta”** të Ligjit Nr. 06/L114 të Ligjit për Zyrtar Publik, KRPP ka nxjerrë dhe publikuar në Platformën elektronike të Prokurimit Publik, përkatësisht në linkun “Legjislacioni dytësor” Rregullat për shërbimet e veçanta, si dhe Dosjen e Tenderit për shërbime të veçanta të cilat kanë hyrë në fuqi me datë 18.11.2020.

Me qëllim të zbatimit të nenit 13 të Ligjit Nr. 07/L-016 për Rimëkëmbjen ekonomike – Covid-19, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.05/L-092 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar Ligji Nr. 05/L-042 për Prokurimin Publik, KRPP ka nxjerrë Njoftimin Nr. 44/2020 me datë 16.12.2020 me të cilin ka autorizuar të gjitha autoritetet kontraktuese që në përputhje me këtë ligj, t’i përfshijnë në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për kontratë informacionet e nevojshme për tenderuesit për trajtimin preferencial të prodhuesve vendor të cilët ofrojnë me ofertën e tyre të gjitha produktet, punët dhe shërbimet vendore.

Meqenëse, që nga mesi i Marsit të vitit 2020 jemi në një situatë të jashtëzakonshme për shkak të Pandemisë Globale COVID-19, me qëllim të lehtësimit të procedurave të prokurimit gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit nga AK, si dhe me qëllim të lehtësimit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik në këto procedura prokurimi, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka nxjerrë dhe publikuar **masat zbatuese** si në vijim:

- **Njoftimi i KRPP-së i datës 16.03.2020** sipas të cilit lejohen AK-të t’i përdorin procedurat e Negociuara pa publikimin e Njoftimit për Kontratë duke iu referuar Vendimit të Qeverisë Nr. 01/11 të datës 15.03.2020 **për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik;**
- **Njoftimi i KRPP-së i datës 30.03.2020** sipas të cilit për shkak të distancimeve dhe/ose kufizimeve sociale dhe ndalimit të punës së Gjykatave me palë në zbatim të masave mbrojtëse, AK-të janë autorizuar që të mos i kërkojnë dëshmitë nga Gjykata dhe nga ATK nga fituesit e kontratës, por fituesit të ofrojnë një “Deklaratë nën Betim” për të dëshmuar se ata janë të përshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së të marrin pjesë në aktivitetet e prokurimit të iniciuara nga AK dhe më vonë kurdo që është e mundur t’i sjellin dëshmitë nga institucionet e lartpërmendura;
- Njoftimi i KRPP-së Nr. 41/2020 i datës 21.04.2020 sipas të cilit autorizohen AK-të që të mos i kërkojnë noterizimin e referencave të specifikuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, si dhe mos të kërkojnë në katalogje që nuk mund të dërgohen përmes platformës elektronike;
- Njoftimi i KRPP-së Nr. 42/2020 të datës 21.04.2020 sipas të cilit janë obliguar AK-të që të mos e kërkojnë Sigurinë e Tenderit më të lartë se 1% të vlerës së parashikuar të kontratës publike;
- Njoftimi i KRPP-së Nr. 40/2020, i datës 21.04.2020 sipas të cilit Autoritetet Kontraktuese autorizohen që t’i zhvillojnë negociatat me operatorët ekonomik në distancë; si dhe
- Njoftimin Nr.32/2020 të datës 10.09.2020 me të cilin autorizohen autoritetet kontraktuese që në këtë situatë pandemie të zgjasin afatin e ekzekutimit të kontratave sipas kërkesave të Operatorëve Ekonomik duke u bazuar në rrethanat e krijuara dhe në nenin 13 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës që flet për “Forcën madhore”.

AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË MONITORIMIT

Departamenti për monitorim dhe mbikëqyrje i KRPP-së kryen detyrat e monitorimit dhe mbikëqyrjes së aktiviteteve të prokurimit të Autoritetet Kontraktuese duke u mbështetur në nenet 81, 88.1 dhe 88.2 të LPP-së nr.04/L-042

Bazuar në nenet e lartëcekura, departamenti i monitorimit dhe mbikëqyrjes ka kompetencë, autoritet dhe përgjegjësi të vëzhgoi mbikëqyrë dhe monitoroi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të nxjerra nga KRPP-ja sipas autorizimit të këtij ligji.

Përbërja e departamentit për monitorim dhe mbikëqyrje

Departamenti për monitorim dhe mbikëqyrje gjatë vitit **2020** ka numruar gjithësej trembdhjetë (13) punëtor, Koordinatorin e departamentit dhe dymbëdhjetë (12) zyrtar, njëmbëdhjetë (11) prej tyre kanë qenë të angazhuar në monitorimin e njoftimeve për kontratë të dërguara për publikim në platformën e E-prokurimit të KRPP-së, monitorimeve të aktiviteteve të prokurimit në bazë të të gjeturave në njoftimet e monitoruara dhe monitorimet sipas kërkesave të autoriteteve kontraktuese, operatorëve ekonomik dhe palëve tjera të interesuara, prej tyre tre (3) punëtorë janë të angazhuar në monitorim si punë dytësore.

KRPP– Departamenti i monitorimit, bënë monitorimin e njoftimeve të autoriteteve kontraktuese të dërguara për publikim përmes Platformës së E-prokurimit si dhe në e-mailin **shpalljekrpp** si: njoftimeve për kontratë, njoftimeve për dhënie të kontratës, njoftimet për anulimin e aktiviteteve të prokurimit, njoftimet për nënshkrimin e kontratës dhe njoftimet tjera.

Prandaj, përmes monitorimit të njoftimeve të aktiviteteve të prokurimit para publikimit të njoftimeve, në Platformën e E-prokurimit, departamenti i monitorimit ka kaluar nga faza e monitorimeve të aktiviteteve të prokurimit të përfunduara dhe konstatimit të lëshimeve, në parandalimin dhe eliminimin e shkeljeve eventuale ligjore para publikimit të njoftimeve, si masë preventive.

Qëllimi i KRPP-së – Departamentit të monitorimit dhe mbikëqyrjes përmes monitorimit të autoriteteve kontraktuese, është të bëhet evidentimi, parandalimi dhe eliminimi i lëshimeve eventuale që kanë të bëjnë me respektimin e ligjit të prokurimit publik nga autoritetet kontraktuese, ngritjes së nivelit të punës me qëllim të shfrytëzimit të drejt, transparent dhe efikas të mjeteve të buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Aktivitetete Departamentit të monitorimit

“KRPP respektivisht Departamenti i Monitorimit, në fillim të vitit 2020, ka paralajmëruar zyrtarët e Autoriteteve Kontraktuese të cilat kanë pas numrin më të madhë të shkeljeve gjegjësisht mosrespektim të dispozitave të legjislacionit për prokurim publik se në rast të vazhdimit gjegjësisht përsëritjes së gabimeve të njëjta, KRPP do të ndërmarr masat e përcaktuara me rregulloren 2/2017, për e revokimin e certifikatës profesionale për prokurim publik”.

Këtë vit, edhe përkundër vështërsive për shkak të situatës së krijuar nga shfaqja e pandemisë Covid 19, Departamenti i Monitorimit është angazhuar maksimalisht për një monitorim sa më cilësor, me qëllim të ngritjes së cilësisë së punës dhe përmirësimin e performancës në fushën e prokurimit publik.

Njoftimet e monitoruara sipas vlerës, të paraqitura në formë tabelare

	Nr. i njoftimeve - totali	Vlerë e Madhe	Vlerë e Mesme	Vlerë e Vogël	Vlerë minimale	Kontrat korniz me një OE	Kontrat kornizë me disa OE
Njoftime për kontratë	2517	318	1659	525	10	134	2
Njoftim për dhënie të kontratës	1602	198	1008	327			
Njoftim për anulim	418	74	254	90			
Njoftim paraprak	13	13					
Njoftim mbi rezultatet e konkursit të projektimit	1	1					
Njoftim mbi konkurset e projekimit	2	1	1				
Kërkesë për shprehje interesi							
Njoftim mbi konkurset e projektimit							
Anulimi i dhënies së kontratës	7	2	4	1			
Njoftimi për parakualifikim- koncesion	2	1	1				
Njoftim për informata shtesë ose përmiresim gabimi	287	82	175	30			
Njoftim për procedurën e negociuar pa publikim	305	26	213	66			
Ftesë për ofertim-shitje	7		3	3	1		
Njoftim për nënshkrim kontrate	2584	121	577	240	1646		
Njoftim i kërkesës për parakualifikim-koncesion							
Njoftim vendimi i AK para publikimit.sipas nenit 43.7 dhe 44.2 të URRPP	770	144	514	106			
Shitja e aseteve - Ankande	19						
Anulim ankandi	3		2	1			
Totali	8537	981	4410	1389	1657	134	2

Njoftimi i anulimit të aktiviteve të prokurimit dhe anulimi i dhënies së kontratës.

Gjatë vitit **2020** janë monitoruar:

- **418** raste të njoftimeve për anulimin e aktivitetit të prokurimit
- **7** raste të njoftimeve për anulimin e dhënies së kontratës.

Njoftime për anulimin e aktivitetit të prokurimit në 418 raste

Nga monitorimet e anulimit të njoftimit për kontratë kemi evidentuar këtë gjendje:

- 105 raste nuk është dorëzuar asnjë ofertë
- 93 raste, nuk ka asnjë ofertë të përgjegjshme
- 47 raste, anulim për shkak të tejkalimit të buxhetit
- 4 raste, anulim për shkak të gabimeve teknike në specifikacion teknik
- 12 raste, një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në proc.e prok.e cila nuk mund të rregullohet apo parandalohet përmes një amandamenti ligjor të prokurimit...
- 69 raste, anulimin **para hapjes së ofertave**, anulim për shkak të ngjarjeve apo arsyeve objektive dhe të domosdoshme të cilat janë jashtë kontrollit të AK dhe të cilat kanë qenë të papatashikuara në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit
- 44 raste, një dispozitë e LPP-së kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit
- 36 raste, me vendim të OSHP-së
- 7 raste, në pajtim me nenin 108 A

- 1 rast - anulim për shkak të riorganizimit- ridestinimit të bugjetit

Anulimi i dhënies së kontratës në 7 raste

- 1 rast, anulimi i dhënies së kontratës sipas nenit 108/A paragrafi 10.2 të LPP-së, dhe
- 5 rast, anulim dhe kthimi në rivlerësim pas ankesës në OSHP
- 1 rast, AK e ka shpallë fitues operatorin ekonomik, mirëpo BQK e ka shpallur kompani të falimentuar

Nenet e LPP-së, me nr.më të madh të shkeljeve të evidentuara gjatë vitit 2020

- Neni 69 - Aftësitë teknike dhe profesionale (përzierja e kërkesave me dëshmi)	169 raste
- Neni 9.5 - Deklarata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmërisë së mjeteve	86 raste
- Neni 68 - Gjendja ekonomike dhe financiare (Përzierje e kërkes. me dëshmi)	56 raste
- Neni 66 - Përshtatshmëria profesionale	30 raste
- Neni 28.2 - Specifikimi teknik	29 raste

Nenet e Rregullores dhe UOPP, me numrin më të madh të shkeljeve- mosrespektimeve

- Neni 18.4 - Dosja e tenderit (përshkrimi jo i qartë i listës së çmimeve)	17 raste
- Neni 18 - Dosja e tenderit pjesa C lista e çmimeve (përshkrimi i pakjartë i çmimeve)	10 raste
- Neni 16 - Numri i prokurimit	09 raste

Përgjigjet dhe monitorimet sipas kërkesës

Departamenti i monitorimit gjatë vitit 2020, ka monitoruar aktivitete të prokurimit sipas kërkesës së OE dhe palëve tjera të interesuara, dhe ka lëshuar gjithësej:

- 390 shkresa, prej tyre:
 - 47 Opinione për procedura të negociuara pa publikimin e njoftimit për kontratë
 - 79 Rekomandime
 - 2 përgjigje
 - 8 monitorime sipas kërkesës
 - 35 Informatë dhe
 - 219 shkresa tjera.

Njoftimet e autoriteteve kontraktuese për procedurat e prokurimit si:

- ***Përdorimi i procedures së negociuar sipas nenit 35 dhe tenderët abnormalisht të ulët nenit 61 të LPP-së –Nr.04/L-042***

Departamenti i monitorimit për vitin 2020, nga AK ka monitoruar njoftimet për këto dy procedura si në vijim:

Neni 35–Procedura e negociuar pa publikimin e njoftimeve për kontratë është shfrytëzuar

- 242 raste,
- 63 raste, punë shtesë (deri në 10% e kontrates bazë)

Monitorimi i procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit për kontratë sipas nenit 35 të LPP-së.

Gjatë vitit 2020, si rezultat i situates së krijuar nga pandemia COVID 19, kryesisht gjatë muajit mars dhe prill kemi pasur një rritje të numrit të zhvillimit të procedurave të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë, gjë që departamenti i monitorimit duke vlerësuar situatën e lartëcekur ka intervenuar më pak në procedurat e negociuara nga Autoritetet kontraktuese.

Departamenti i monitorimit nga 242 procedura të negociuara duke mos llogaritur punët shtesë, në 47 raste ka lëshuar opinione me shkrim prej të cilave në 18 raste (procedura) janë zbatuar rekomandimet e KRPP-së dhe si rezultat i zbatimit të rekomandimit AK-se kanë rishëryrtuar vendimet fillestare për përdorim të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë duke aplikuar procedurën e hapur për këto aktivitete të cilat janë listuar në tabelën si më poshtë. Derisa në 29 raste të tjera të monitoruara AK-se kanë vazhduar me procedurë të negociuar.

Tabela 1: AK-të të cilat kanë zbatuar rekomandimin e KRPP-së

Nr	AK	Përshkrimi i Aktivitetit	Vlera e parashikuar	Zbatimi i rekomandimit të KRPP-së
1	Policia e Kosovës	“Ndërtimin e Stacionit të Policisë në Gjakovë”	92,000.00 €	Zbatim i rekomandimit
2	KK Prishtinë	“Punimi shpimeve dhe Elaboratit Gjeomekanik”	55,000.00 €	Zbatim i rekomandimit
3	KK Kamenicë	“Furnizim me pajisje MCDM-Money Card Document Machine”	45,000.00 €	Zbatim i rekomandimit
4	KK Prishtinë	“Trajtimi i qeneve endacake”	20,000.00 €	Zbatim i rekomandimit
5	Qendra e Studentëve	“Furnizim Shërbim të Internetit për Nevojat e Studentëve ne Konvikt të QS”	20,000.00 €	Zbatim i rekomandimit
6	MKRS	“Masat Preventive Intervenimet Emergjente, Shtëpi Banimi Kurtesh Sylejmani në Prishtinë, Shtëpi Banimi Musli Hoxha në Prishtinë, Shtëpi Banimi Sali Safqi në Prishtinë, Konservimi Restaurimi i Shtëpisë së Hynilerëve në Prishtinë”	710,000.00 €	Zbatim i rekomandimit
7	KK Prishtinë	“Art ne Hapësira Publike”	50,000.00 €	Zbatim i rekomandimit
8	MSH	“Favipiravir dhe Remdesivir për luftimin e pandemisë Covit 19”	2,400,000.00 €	Zbatim i rekomandimit
9	Mitrovica e Veriut	“Prokurimi i Materialeve të konsumit-Mbështetje për sipërmarrësit në periudhe e luftës kundër kovid”	297,000.00 €	Zbatim i rekomandimit
10	MKRS	Stadiumin e Qytetit “Shahin Haxhi Islami” në Pejë	12,800,000.00 €	Zbatim i rekomandimit
11	KEK	“Shërbime konsulentë për menaxhimin e projektit për sistemin ERP”	13,000.00 €	Zbatim i rekomandimit
12	MSH	“Adaptimi i Klinikës së Re Emergjente për nevoja të Covid-19”	18,600,000.00 €	Zbatim i rekomandimit
13	Policia e Kosovës	“Shërbimet e Sigurimeve Emergjente të Automjeteve të PK-ës”	123,000.00 €	Zbatim i rekomandimit
14	KRU GJAKOVA	Hapja e pusit për ujë të pijes, me Nr. Prokurimi 20-5639-525	36.550,00 €	Zbatim i rekomandimit
15	SHSKUK	Zhvillimi dhe mirëmbajtja e softuerit Nr. i prokurimit 20-7585-225	50 000.00 €	Zbatim i rekomandimit

16	SHSKUK	Furnizim me inventar Nr. i prokurimit 220-20-085-115	2,415,000.00 €	Zbatim i rekomandimit
17	AVU	Zhvillimi dhe mirëmbajtja e softuerit Nr. i prokurimit 20-7585-225	50 000.00 €	Zbatim i rekomandimit
18	SHSKUK	Shërbime Funerale Nr. 20-105-215	280 000.00 €	Zbatim i rekomandimit
Vlera e parashikuar në total e procedurave pa publikim të njoftimit për kontratë, të anuluara:			38.006,550.00 €	

Ndërhyrjet:

Nr. më i madh i ndërhyrjeve **gjatë vitit 2020** ka qenë tek, Autoritetet kontraktuese:

- KK Ferizaj 35 ndërhyrje
- Trepça 22 ndërhyrje
- KK Klinë 14 ndërhyrje
- KK Viti 12 ndërhyrje
- SHKK 12 ndërhyrje
- Ministria e Arsimit 12 ndërhyrje
- Qendra e Studentëve 11 ndërhyrje
- KK Drenas 10 ndërhyrje
- Ministria e kulturës, rinisë dhe sportit 9 ndërhyrje
- KK Pejë 9 ndërhyrje
- KK Suharekë 9 ndërhyrje
- KK Lipjan 8 ndërhyrje
- Ministria e Infrastrukturës 7 ndërhyrje
- KK Kamenicë 7 ndërhyrje
- KK Prizren 7 ndërhyrje

Vërejtje për zyrtarët e prokurimit:

Gjatë këtij vitit 2020 janë shqiptuar nëntë (9) **vërejtje me shkrim** për zyrtarët:

- Zyrtarin përgjegjës të Prokurimit në Universitetin e Prishtinës - Vërejtje
- Zyrtarin përgjegjës të prokurimit të KK Prizren - Vërejtje
- Zyrtaren përgjegjëse të prokurimit të Gjykatës kushtetuese të Kosovës - Vërejtje
- Zyrtarin përgjegjës të prokurimit të KEK- ut - Vërejtje
- Zyrtarit përgjegjës të prokurimit të KK Mitrovicë - Vërejtje
- Zyrtarit përgjegjës të prokurimit të KK VITI - Vërejtje
- Zyrtarit përgjegjës të prokurimit të KK Leposaviq -Vërejtje
- Zyrtarit përgjegjës të prokurimit të Spitali Ferizaj -Vërejtje
- Zyrtarit përgjegjës të prokurimit të KK Ferizaj -Vërejtje

Synimet e Departamentit të monitorimit dhe mbikëqyrjes

- Synimet e departamentit të monitorimit për vitin 2021 janë, që përmes monitorimit të njoftimeve të autoriteteve kontraktuese të dëguara për publikim në Platformen Elektronike të E-prokurimit në KRPP dhe monitorimeve të aktiviteteve të prokurimit sipas kërkesës së operatorëve ekonomik dhe palëve tjera të interesit, të bëhet evidentimi, parandalimi dhe eliminimi i lëshimeve eventuale që kanë të bëjnë me respektimin e ligjit të prokurimit publik dhe legjislacionit sekundar në fuqi nga autoritetet kontraktuese, ngritjen e nivelit të punës me qëllim të shfrytëzimit të drejt, transparent dhe efikas të mjeteve të buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe të gjitha fondeve dhe burimeve tjera.

- Të siguroi integritetin dhe përgjegjësin e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave tjerë që janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, si dhe të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar, të paanshme dhe etike tek zyrtarët e prokurimit dhe zyrtarve tjerë të involvuar në procesin e prokurimit publik.

AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË TRAJNIMEVE DHE INTEGRIMEVE EUROPIANE

Departamenti për trajnime dhe Integritet, përmes programeve për Trajnime në vazhdimësi ka qenë një përkrahëse i fuqishme për krijimin dhe zhvillimin e një kuadri modern dhe profesional në fushën e prokurimit publike.

Besoj shumë në atë se njohuritë e fituara nga këto programe të trajnimit, zyrtarët do t'i zbatojnë në institucionet e tyre përkatëse, gjatë kryerjes së prokurimeve publike dhe dhënies së rekomandimeve adekuata, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e funksionimit të sistemit të prokurimit në Kosovë .

Raporti pasqyron punën një vjeçare të Departamentit për trajnime dhe Integritet që ekziston në kuadër të KRPP-së i cili raport përfshinë :

- Trajnimin Themelor profesional për prokurimit ;
- Trajnimin i Avancuar profesional për prokurim;
- Pilot program për trajnimin e dy moduleve; menaxhimi i kontratës dhe vlerësimi i performancës se OE .
- Trajnimi për trajner për tri Institucionet e prokurimit publik (KRPP, OSHP & AQP)

Pra, raporti përmban, përshkrimin e moduleve të programeve të trajnimeve, pjesëmarrjen , vijueshmërinë, monitorimin dhe mbikëqyrjen e trajnimeve, angazhimin e trajnerëve për programet e trajnimit, Testimin – Ri testimin e pjesëmarrësve të trajnimit, dhe pajisjen me certifikata për pjesëmarrës.

Programi i trajnimit “ Trajnim Themelor Profesional për Prokurimit”

Sipas LPP, zyrtarët përgjegjës të prokurimit dhe nëpunësit e prokurimit, fillimisht, duhet të posedojnë një certifikatë të vlefshme themelore, në mënyrë që t'u lejohej të marrin përsipër detyrat e tyre në zyrat e prokurimit të Autoriteteve Kontraktuese.

Përshkrimi i programit themelor profesional : Ky program ka qenë i strukturuar në 15 module trajnimi si në vijim:

1. Sistemi i Prokurimit Publik në Kosovë - Ligji i Prokurimit Publik.
2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik
3. Integriteti në prokurimin publik
4. Procedura e Hapur
5. Procedura e kufizuar
6. Procedura konkurruese me negociata
7. Procedura e negociuar pa publikim
8. Përgatitja e Dosjes se tenderit
9. Prokurimi i shërbimeve të përgjithshme
10. Prokurimi i shërbimeve - Konsulente
11. Kontratat publike kornizë

12. Menaxhimi i kontratës
13. Ankesat dhe procedurat e shqyrtimit
14. E- prokurimi për Autoritetet Kontraktuese
15. E- prokurimi për Operatoret Ekonomik

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) në mbështetje të nenit 25 të Ligjit Nr. 04/L-42 për prokurim publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, me datën 09.03.2020 - 25.03.2020 ka njoftuar se do të filloj me organizimin e programit për trajnim të zyrtarëve që do të pajisen me certifikatë Themelore profesionale për prokurim në vitin 2020.

Pra me datën 09.03.2020 - 25.03.2020 është bërë njoftimi për aplikime për të gjithë të interesuarit për këtë program në faqen e KRPP-së. Aprovimi për tu bërë pjesë e këtij programi (për aplikuesin) është dashur ta bëjë, Zyrtari Kryesor Administrativ duke e nënshkruar dhe vulosur aplikacionin e personit të propozuar.

Mirëpo për shkak të situatës së pandemisë dhe vendimit të qeverisë - KRPP ka njoftuar se afati për dorëzim të aplikacioneve pezullohet nga data 12.03.2020 deri me datën 15.06.2020, në përputhje me masat e paralajmëruar nga qeveria e Kosovës për situatën aktuale në vendin tonë.

Me datën 15.06.2020 KRPP ka njoftuar se afati për aplikim do të vazhdohet dhe aplikacionet duhet të dorëzohen në mënyrë elektronike pra duke e skanuar aplikacionin e nënshkruar dhe të vulosur në i-mell adresën, trajnimet.krpp@rks-gov.net më së largu deri me 24.06.2020. Pas dorëzimit të aplikacioneve KRPP-ja, ka bërë përzgjedhjen e aplikuesve dhe ka përpiluar listën e pjesëmarrësve në programin themelor profesional për vitin 2020. Kështu, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP) kanë publikuar njoftimin për fillimin e mbajtjes së trajnimit nga data 03.08.2020 deri me 26.08.2020, për të gjithë zyrtarët të cilët kanë qenë në listë.

Trajnimi i cili për shkak të situatës së pandemisë për herë të parë është mbajtur në formën virtuale (në distancë) përmes platformës elektronike "Skype for Business", të cilën e ka lancuar IKAP.

Për Programin themelor Profesional të prokurimit janë përpiluar listat për 6 grupe të pjesëmarrësve në trajnim, plani kalendarik si dhe Agjenda e trajnimit për secilin modul. KRPP-ja për këtë program gjithashtu ka përgatitur dhe ka publikuar të gjitha modulet e programit në tri gjuhë (shqip, serbisht dhe anglisht) të cilat mund të gjenden në adresë <https://e-prokurimi.rks-gov.net/>.

Të gjithë pjesëmarrësit e trajnimit që kanë qenë në listë kanë qenë të obliguar që të përcjellin trajnimin me rregull dhe në fund t'i nënshtrohen testit.

Meqenëse Ligji aktual për Prokurim Publik në Kosovë nuk e ka të përcaktuar qartë, bazën ligjore për mënyrën e angazhimit dhe pagesës së trajnerëve që do të angazhohen për mbajtjen e moduleve për programet e trajnimit në prokurim. Atëherë KRPP-ja në bashkëpunim me IKAP ju ka bërë thirrje 39 trajnerëve, pra të gjithë trajnerëve të certifikuar nga IKAP që të aplikojnë

(të përcaktohen) për modulet që mund ti ligjërojnë dhe ti mbajnë më së miri, duke ju dhënë një afat prej 17.07.2020 deri me 22.07.2020 me qëllim që ky programe i trajnimit të jetë sa me i mirë dhe kualitative. Thirrjes se KRPP-se ju kane përgjigjur vetëm 27 trajnerë , ndërsa të tjerët kane dhënë sqarime për hezitimin e tyre për tu angazhuar ne një situatë të pandemisë ne të cilën është vendi dhe nuk dëshirojmë të angazhohemi ne kete kohë.

Te gjithë trajnerët qe janë përcaktuar për module janë angazhuar ne mënyrë të barabarte dhe të drejt dhe duke marre parasysht eksperiencë profesionale dhe shkathtësitë e tyre prej trajneri, të cilët kane mbajtur gjithësej 90 dite trajnim.

Vijueshmëria e pjesëmarrësve ne trajnim dhe Organizimi i testeve për pjesëmarrës

Mbikëqyrjen e trajnimit dhe evidencen e vijueshmërisë për pjesëmarrës e ka bere IKAP.

Në përfundim të programit të trajnimit, IKAP ne bashkëpunim me KRPP ka përgatitë listën përfundimtare duke u mbështetur ne vijueshmërinë e pjesëmarrësve të cilët ju kane nënshtruar testimit për të u pajisur me certifikatën Themelore profesionale për Prokurim / 2021-2023.

Testi është organizuar me datën 30.09.2020 në Sallën e madhe të IKAP ne të cilën kane marr pjesë 166 pjesëmarrës prej tyre 140 kane kaluar testin ndërsa Ri-test është mbajtur me datën 13.10.2020, në IKAP ne të cilën kane marre pjesë 21 pjesëmarrës dhe prej tyre kane kaluar RI-TESTIN 20 pjesëmarrës .

Testi është përgatitur dhe përpiluar nga komisioni i përcaktuar me vendim të Kryetarit të KRPP. Ne test kanë dominuar pyetjet e hapura përmes të cilave janë testuar aftësitë për zgjidhjen e situatave që mbart sistemi i prokurimit dhe sfidat që mund të kenë zyrtaret në të ardhmen. Pjesëmarrësit të cilët kane arritur kalueshmëri të testit në masën mbi 55 pik (160) janë pajisur me certifikatën themelore Profesionale të prokurimit, e cila është e vlefshme për tre vjet me radhë (2021-2023).

Trajnim i Avancuar Profesional për prokurim

Personi i cili mban një certifikatë themelore të prokurimit dhe i cili nuk arrin të marrë certifikatën e avancuar brenda kësaj periudhe tri (3) vjeçare e humb të drejtën për të shërbyer si Zyrtar përgjegjës i Prokurimit përderisa ai/ajo të marrë certifikatën e avancuar. Certifikatat e avancuara kanë validitet të përhershëm dhe në rast se KRPP-ja organizon trajnime, bartësit e tyre janë të obliguar që të ndjekin trajnimet.

Përshkrimi i Programit të Avancuar Profesional : Ky program ka qene i strukturuar në 10 module trajnimi si në vijim:

1. Menaxhimi i rrezikut: Identifikimi i nevojave të prokurimit dhe faza para-tenderimit
2. Konkurs i projektimit
3. Përgatitja e specifikimeve teknike dhe funksionale
4. Menaxhimi i rrezikut: Faza e Tenderimit
5. Tenderi ekonomikisht me i favorshëm
6. Vlerësimi i tenderit duke përdorur kriteret e peshuara dhe shpenzimet e jete-gjatësisë
7. Ndikimet sociale dhe ambientale
8. Menaxhimi i ndryshimeve të kontratës (praktikat më të mira në zbatimin e variacioneve).

9. E-prokurimi - MENAXHIMI I Kontratave përmes platformës
10. E-prokurimi – Vlerësimi i Performancës së Kontraktorëve (CPE)", si pjesë e sistemit të prokurimit elektronik

Komisioni Regullativ i Prokurimit Publik (KRPP) ne mbështetje të nenit 25 të Ligjit Nr. 04/L-42 për prokurim publik i ndryshuar dhe plotësuar ka njoftuar me datën 09.11.2020 se do të filloj me organizimin e programit për trajnim të zyrtarëve që do të pajisen me certifikatë të Avancuar profesional për prokurim.

Në këtë program kane marre pjesë të gjithë zyrtaret të cilët kanë pasur certifikatë Themelore Profesionale të prokurimit me validitete 2018-2020, të cilët janë të obliguar sipas Ligjit ta përcjellin trajnimin 10 dite.

Për Programin e Avancuar Profesional të prokurimit KRPP-ja ka përpiluar si në vijim :

Listat e grupeve , plani kalendarik i mbajtjes së trajnimit, materialet për modulet e trajnimit ,agjenda për modulet e trajnimit.

Kështu , Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik (KRPP) dhe Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP), ka filluar trajnimi me datën 16.11.2020 - 11.12.2020 për programin i cili është mbajtur në formën virtuale (në distancë) përmes-platformës elektronike “Skype for Business”, të cilën e ka lancuar IKAP. Ne programin e Avancuar Profesional të prokurimit kane marre pjesë gjithësej 213 Zyrtare.

KRPP-ja për këtë program gjithashtu ka përgatitur dhe ka publikuar të gjitha modulet e programit ne tri gjuhët (shqip, serbisht dhe anglisht) të cilat mund të gjenden në adres <https://e-prokurimi.rks-gov.net/>.

Të gjithë pjesëmarrësit e trajnimit që kane qene në listë kane qene të obliguar që të përcjellin trajnimin me rregull dhe në fund t'i nënshtrohen testit.

Pjesëmarrësit në trajnim kanë diskutuar për praktikën më të mira dhe vështirësitë më të cilat përballen në proceset e prokurimit. Trajnimi ka qene i pasur me shembuj dhe studime të rasteve nga praktikën vendore dhe ndërkombëtare në prokurim.

KRPP-ja ka bere thirrje trajnerëve që të aplikojn (të përcaktoheni) për modulet që mund ti ligjëroni dhe ti mbani më së miri, me qëllim që ky programe i trajnimit të jetë sa me i mirë dhe kualitative. të gjithë trajnerët që janë përcaktuar për module janë angazhuar ne mënyrë të barabarte dhe të drejt dhe duke marre parasysh eksperiencë profesionale dhe shkathtësitë e tyre prej trajneri, të cilët kane mbajtur gjithësej 60 dite trajnim.

Vijueshmëria e pjesëmarrësve ne trajnim dhe Organizimi i testeve për pjesëmarrës

Mbikëqyrja e trajnimit dhe evidenca e vijueshmërisë për pjesëmarrës është bere nga IKAP.

Në përfundim të programit të trajnimit KRPP-ja ka përgatitë listën përfundimtare duke u mbështetur ne vijueshmërinë e pjesëmarrësve të cilët ju kane nënshtuar testimit për të u pajisur me certifikatën të Avancuar profesionale për Prokurim.

Testi është organizuar me datën 24.12.2020 në KAP ne të cilën kane marr pjesë 169 pjesëmarrës prej tyre 125 kane kaluar testin ndërsa Ri-test është mbajtur me datën 28.01.2021, në IKAP ne të cilën kane marre pjesë 51 pjesëmarrës dhe prej tyre kane kaluar RI-TESTIN 44 pjesëmarrës.

Trajnim plotësues për programin e avancuar profesional

IKAP dhe KRPP janë pajtuar që të bëhet një trajnime plotësues për programin e avancuar profesional për prokurim për të gjithë personat të cilët kane certifikatën themelore profesionale 2018-2020 dhe si të tillë kane qene pjesë e listës ne fillim të trajnimit por për arsye të ndryshme nuk kane mundur ta ndjekin trajnimin dhe si rezultat nuk kane pasur vijueshmërinë e nevojshme për të ju nënshtruar Testit .

KRPP- IKAP ka njoftuar se trajnimi do të filloj nga data 01- 05.02.2021 dhe do të jete intensiv për një periudhë të shkurte 5 ditore. Trajnimi është mbajtur për çdo dite në mënyrë elektronike përmes platformës skype for business, sipas planit kalendarik të përpiluar për grupin.

Pas përfundimit të trajnimit plotësues për programin e Avancuar Profesional është mbajtur testi për këta pjesëmarrës me datën 11.02.2021 ne të cilin kane marre pjesë 8 zyrtar të cilët e kane arritur kalueshmërinë prej 65 pik 8 zyrtare .

Përfundimisht 177 zyrtare e kane arritur kalueshmërinë ne testit në masën mbi 65 pik , të cilët do të pajisen me certifikatën të Avancuar Profesionale të prokurimit.

Edhe pse ky vite ishte vite me pandemi – kovid 19, rezultatet e bashkëpunimit dhe koordinimit ne trajnime eidentojnë faktin se ky vit ishte i mire, indikatorët eidentojnë se në këtë vite janë certifikuar dhe pajisur me certifikatë 160 zyrtarë të prokurimit nëpërmjet programit themelor profesional të trajnimit dhe 177 zyrtarë janë certifikuar dhe pajisur me certifikatë të Avancuar profesionale për prokurim .

Gjatë këtij viti, përfitues të trajnimeve ishin Zyrtaret nga niveli Qendror, Lokal, Organizatat e Shoqërisë Civile , Zyrtaret e prokurimit të Agjencioneve të pavarura, kompanive publike dhe një numër i organizatave të tjera.

Pilot Programi për dy modulet e platformës – Menaxhimi i Kontratës dhe Vlerësimi i performancës së kontraktuesve

KRPP-ja në bashkëpunim me projektin TEAM e mbështetur nga USAID ka bere përzgjedhjen e pjesëmarrësve ne pilot projektin për trajnim me titull - "Zhvillim dhe implementim të moduleve për menaxhim të kontratës dhe vlerësim të performances se kontraktuesve".

Pilot projekti ka përfshi mbajtjen e dy moduleve të reja të trajnimit që kane të bëjnë me Menaxhim të Kontratës dhe vlerësim të performances se Kontraktuesit të cilat do të fillojnë të implementohen ne të ardhmen e afërmen nga të gjitha Autoritete Kontraktuese ne platformën elektronike të prokurimit.

Trajnimi është zhvilluar më 14.09.2020 deri më 18.09.2020 në platformën e takimeve online TEAMS, duke filluar nga ora 10:00am deri ne 15:00pm.

Në trajnim kanë marre pjesë zyrtarët të TI-së të KRPP-se të cilët do jene të kyçur drejtpërdrejtë ne fazat e mëtutjeshme të trajnimeve dhe ofrim të ndihmës për përdoruesit e këtyre dy moduleve si pjese e sistemit të prokurimit elektronik.

Në trajnim kane marre pjesë zyrtaret nga niveli Lokal siç janë : Komuna e Prishtinës, Gjakovës , Gjilanit , Vushtrisë , Pejës ndërsa nga niveli qendror : Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria

e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Infrastrukturës, Agjencioni Qendror i Prokurimit Etj.

Qëllimi i këtij trajnimi ka qene qe t'u jepet pjesëmarrësve njohuri të mjaftueshme mbi funksionalitetet e të dy moduleve, nderveprimin me proceset aktuale ne sistem të prokurimit elektronik dhe demonstrimin me shembuj konkret nga procedurat të përfshira në modulet CM dhe CPE.

“Trajnimi per trajner” për tri Institucione të prokurimit publik (KRPP, OSHP & AQP)

Trajnimi është mbajtur nga Instituti i njohura ne fushen e trajnimeve per prokurimin publik ITC-ILO (International Training Center-International Labor Organization, Torino-Itali).

KRPP – ja ju ka bere ftes institucioneve kryrsore të prokurimit per të percaktuar secili nga instuticioni i vete zyrtaret per ta ndjekur trajnimin per trajner me titull “ Menaxhimi i Prokurimit Publik sipas Sistemit të BE (ToT FOR PUBLIC PROCUREMENT MANAGEMENT UNDER THE EU SYSTEM). Dy instuticione të prokurimit siq jane KRPP dhe AQP kane percaktuar zyrtaret , ndersa OSHP nuk ka percaktuar askend .

Pra trajnimin e kane perciell gjithësejte 10 zyrtare ne periudhe prej 10 diteve - nga 5 tetori deri me 15 tetor 2020 . Per shkak të situates se krijuar me pandemine Covid-19, trajnimi është mbajtur ne formatin online.

Trajnimi kishte per qellim të forcojë kapacitetet njerëzore dhe institucionale në Kosove me Direktivat e BE-së për prokurimin publik dhe praktikave me të mira.

KRPP, si njëra nga organet qendrore në fushën e prokurimit publik, që është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të prokurimit publik në Kosove, ka edhe përgjegjësitë kryesore për proceset e Integritimit Evropian në fushën e prokurimit publik.

Komfor kompetencave dhe përgjegjësi të dhëna me LPP , KRPP-ja duhet të ndër veprojë dhe të bashkëpunojë me organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit për çështjet që lidhen me prokurimin publik. Në këtë konteste Departamenti për trajnime dhe integritet – Divizioni per Integritet në vazhdimësi ka mbajtur takime, ka raportuar dhe bashkëpunuar sa i përket fushës së prokurimit publik në MIE, MF, DIEKP, OECD-SIGMA dhe institucionet tjera.

Përmes këtyre takimeve, raportimeve dhe bashkëpunimeve është synuar që të pasqyrohet puna dhe gatishmëria e KRPP-së karshi Institucioneve Qeveritare dhe institucioneve ndërkombëtare si Zyra e BE-së, SIGMA, Banka Botërore dhe OJQ .

Gjate vitit 2020 janë kryer këto raportime siç janë : Raportime të rregullta dhe takime për Programin Kombëtar të Zbatimit të MSA-së (PKZMSA), Raportimet rreth zbatimit të PKZMSA-së për vitin 2020, si në matricën e raportimit ashtu edhe në dokumentin narrativ dhe rishikimin e PKZMSA-së për vitin 2021, Raportime të rregullta në MIE për Raportin e KE-së për Kosovën për vitin 2020, Raportim vjetor në Vlerësimin e SIGMA-së, etj.

AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË TI-së DHE PROKURIMI ELEKTRONIK

Aktivitetet e Departamentit të TI-së

Gjatë vitit 2020, edhe pse ishte një vit i shoqëruar me situatën e shkaktuar nga pandemia, Departamentit të Teknologjisë së Informacionit ka operuar me të gjitha kapacitetet dhe është fokusuar plotësisht në aktivitetet si në vijim:

- Administrimin e përditshëm të infrastrukturës harduerike dhe softuerike të sistemit të prokurimit elektronik, parandalimin, evitimin dhe zgjidhjen e problemeve për të siguruar qëndrueshmëri dhe operim të pandërprerë të Sistemit të Prokurimit Elektronik, 24 orë në 7 ditë të javës;
- Aplikimin e procedurave standarde të TI-së në ruajtje dhe arkivim në bazë ditore të të dhënave të sistemit të prokurimit elektronik.
- Bashkëpunim dhe koordinim me institucionet e Ministrisë së Administratës Publike/Agjencionit të Shoqërisë së Informacionit dhe Ministrisë së Financave, si institucione të përfshira në mënyrë direkte dhe indirekte në operim të sistemit të prokurimit elektronik;
- Ofrim të shërbimeve në dhënie të ndihmës teknike dhe instruksioneve nëpërmjet tavolinës ndihmëse (linjë telefonike, postë elektronike dhe prezencë fizike) për të gjithë përdoruesit e autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik gjatë përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik;
- Dhënie e ndihmës teknike dhe mbështetjes për të gjithë stafin e KRPP-së, departamentin e rregullave, monitorimit dhe trajnimeve, në funksion të rritjes së njohurive në përdorim të funksionaliteteve të sistemit të prokurimit elektronik dhe transformimit nga prokurimi tradicional në atë elektronik;
- Pasurim i dy portaleve të KRPP-së, <https://krpp.rks-gov.net/> dhe <https://e-prokurimi.rks-gov.net/>, me informacione, pyetje të shpeshta, njoftime dhe vendime të përgatitura nga KRPP dhe publikuar për publikun e gjerë.

Aktivitetet nga Sistemi i Prokurimit Elektronik

Gjatë vitit 2020 sistemi i prokurimit elektronik ka qenë funksional dhe në operim të plotë për zhvillim të të gjitha aktiviteteve të prokurimit (me vlerë mbi 1000 Euro) në formë elektronike nga ana e autoriteteve kontraktuese, dhe në funksion të plotë të përgaditjes dhe dorëzimit të ofertave në formë elektronike nga të gjithë operatorët ekonomik të rexhistruar në sistem të prokurimit elektronik.

Gjatë vitit 2020, si aktivitete kryesore të evidentuara në përdorim të sistemit të prokurimit elektronik, janë:

- Të gjitha ofertat në aktivitete të prokurimit (me vlerë mbi 1000 Euro) janë përgaditur dhe dorëzuar nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik – rreth 25,500 oferta në të gjitha procedurat.

- Të gjitha **(197)** AK janë të regjistruara dhe përdorin platformën e prokurimit elektronik
- Ka arritur në rreth **9,450** numri i OE të regjistruar të cilët përdorin platformën në mënyrë aktive
- Numri i të gjithë përdoruesve të regjistruar ka arritur në rreth **24,800**
- **19,780** publikime të të gjitha llojeve (në 2020) nga **73,000** publikime që deri më tani janë pjesë e platformës;
- **6, 657** procedura të prokurimit janë zhvilluar (përgaditur dhe publikuar), nga të cilat rreth **5,389** kanë përfunduar me nënshkrim kontrate;
- Të gjitha publikimet në prokurim elektronik janë transparente publike dhe të qasshme për cdo palë të interesit, përfshirë kontratat e nënshkruara dhe dokumentet mbi vlerësimin e ofertave të eliminuara dhe shpërblyera (vendimet e AK-se mbi vlerësimin e ofertave dhe letrat standarde për tenderuesit e suksesshëm dhe të eliminuar);
- Është reduktuar në maximum kontakti fizik i zyrtarëve të prokurimit me OE potencial pjesëmarrës në procedura të prokurimit;
- Është mundësuar monitorimi i aktivitetetve të prokurimit në kohë reale dhe në cilëndo fazë të aktivitetit – nga na e monitorimit të KRPP-së,
- Është mundësuar qasja në sistem për auditorët e brendshëm dhe të jashtëm për ta përdorur sistemin për auditim të të gjitha aktiviteteve të prokurimit të zhvilluara dhe përfunduara nëpërmjet sistemit të prokurimit;
- Platforma e prokurimit elektronik është nga sistemet më të përdorura në nivel qeveritar, të përdorura nga bizneset, qytetarët dhe cilado palë e interesit;
- Sistemi i prokurimit elektronik është përdorur plotësisht për përgaditje, procesim dhe trajtim të ankesave në OSHP, përfshirë përgaditjen dhe procesimin e kërkesave për sqarime dhe kërkesave për rishqyrtim nga an e OE;
- Është bërë publikimi i rregullt në portalin qeveritar <https://opendata.rks-gov.net/> i të gjitha kontratave të nënshkruara nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik;

Disa nga statistikat mbi aktivitetin e përgatitjes së procedurave të prokurimit, publikimit të njoftimeve dhe ofertave të dorëzuara gjatë vitit 2020 janë dhënë si me poshtë:

Statistikat e publikimeve të të gjitha njoftimeve dhe ofertave të dorëzuara gjatë vitit 2020	
Lloji i njoftimit	Numri
Njoftim paraprak	78
Njoftim për kontratë (B05)	5874
Njoftim standard për korrigjim të gabimeve në njoftimet e publikuara (B54)	1412
Njoftim për konkurse të projektimit (B06)	27
Njoftim për dhënie të kontratës (B08)	5643
Njoftim për nënshkrim të kontratës (B52)	5389⁷
Njoftim për rezultatet e konkursit të projektimit (B09)	18
Njoftim për anulim të aktivitetit të prokurimit (B11)	1300
Oferta të dorëzuara nga OE në të gjitha aktivitetet e prokurimit	25, 500

Aktivitetet në funksion të përmirësimit të Sistemi i Prokurimit Elektronik

Nga aktivitetet e vitit 2020 që kanë qenë në funksion të përmirësimit të sistemit të prokurimit elektronik, duhet vecuar:

- Implementimi dhe konfigurimi i paisjeve të reja harduerike për ngritjen një infrastrukture të re të sistemit të prokurimit elektronik;
- Migrimi i të dhënave dhe transferimi i sistemit të prokurimit elektronik nga infrastruktura e vjetër në infrastrukturë të re, dhe i cili migrim/transferim është bërë në tërësi nga stafi i TI-së së KRPP-së.
- Zhvillimi dhe konfigurimi i aplikacionit të sistemit të prokurimit elektronik për t'a përshtatur dhe mundësuar aplikimin e procedurave të prokurimit për kontrata për shërbime të vecanta;
- Zhvillimi, implementimi dhe testimi i moduleve të reja të sistemit të prokurimit elektronik: i) moduli për menaxhim të implementimit të kontratave, dhe ii) moduli për vlerësim të performancës së kaluar të kontraktuesve, të cilat module janë mbështetur nga projekti i USAID/TEAM.
- Realizimi i fazës pilotuese (me AK-se të selektuara) të dy moduleve të reja i) modulit për menaxhim të implementimit të kontratave, dhe ii) modulit për vlerësim të performancës së kaluar të kontraktuesve;

⁷ 783 njoftime i takojne procedurave të negociaura pa publikim të njoftimit për kontratë

- Realizimi i materialeve video-trajnuese për përdorim të modulit për menaxhim të kontratave dhe modulit për vlerësim të performancës.

Duhet theksuar që avancimi i infrastrukturës harduerike të sistemit të prokurimit elektronik është bërë në tërësi nga zyrtarët e TI-së në KRPP, përfshirë migrimin e të dhënave dhe të gjitha funksionaliteteve të sistemit të prokurimit elektronik.

I gjithë aktiviteti i kalimit në infrastrukturë të re është bërë në mënyrë të suksesshme duke mos rëxhistruar asnjë problem teknik dhe ndërprerje të operimit të sistemit të prokurimit elektronik.

Derisa, edhe pse zhvillimi, implementimi, testimi dhe faza e pilotimit të moduleve të reja, modulit për menaxhim të kontratave dhe vlerësim të performancës së kontraktuesve, është përmbyllur gjatë vitit 2020, vënia në përdorim është shtyer për fillim të vitit 2021 shkaku i gjendjes së krijuar me pandeminë globale.

Gjithashtu gjatë vitit 2020 KRPP ka vazhduar edhe më tutje në avancim të transparencës së të dhënave të prokurimit publik. Për këtë qëllim stafi i KRPP-së ka zhvilluar aplikacionin softuerik për publikim të të dhënave të prokurimit publik sipas standardit OCDS (Open Contracting Data Standard). Aplikacioni softuerik në versionin testues është publikuar nëpërmjet linkut <https://ocdskrpp-test.rks-gov.net/> duke mundësuar palëve të interesuara që të dhënat e publikuara nëpërmjet këtij aplikacioni të konsumohen në formatet e lexueshme dhe të përpubohen për çështje statistikore dhe analitike.

Pas fazës testuese KRPP këtë aplikacion gjatë vitit 2021 do t'a kalojë nga ambienti testues në ambientin real, duke synuar që të dhënat e aktiviteteve të prokurimit përveç publikimit të tyre në sistem të prokurimit elektronik t'i publikoj edhe sipas standardit OCDS.

PËRKRAHJA E SISTEMIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË NGA INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE

PERKRAHJA NGA USAID-i

Edhe gjatë vitit 2020, a vazhduar përkrahja e sistemit të prokurimit publik nga USAID nëpërmjet projektit TEAM (Transparenca, Efikasiteti dhe Llogaridhenia ne Komuna). Përkrahja e projektit TEAM ka përfshirë nivelin qendrorë (KRPP-në) dhe nivelin lokal (komunat).

Në nivelin qendror përkrahja e projektit është fokusuar në:

- Mbështetjen e KRPP-së me ekspertë të TI-së, me qëllim të shkëmbimit të ekspertizës dhe ngritjes së kapaciteteve të stafit të TI-së përgjegjës për sistem të prokurimit elektronik;
- Përkrahje financiare në zhvillim të moduleve dhe funksionaliteteve të reja të sistemit të prokurimit elektronik, si:
 - a) moduli për menaxhim të implementimit të kontratave dhe**
 - b) moduli për vlerësim të performancës së kaluar të kontraktuesve.**
- Mbështetje në përgaditjen dhe finalizimin e video – tutorialeve që udhëzojnë dhe përdorim të sistemit të prokurimit elektronik nga ana e përdoruesve të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik.

Në nivelin lokal (komunat) përkrahja e projektit të USAID gjatë vitit 2020 ka patur një shtrirje më të gjerë në krahasim me vitet paraprake dhe kjo përkrahje edhe më tutje është fokusuar në:

- Ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të prokurimit në komunat fokus (Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Gjiilan dhe Vushtri) dhe në disa komuna të tjera nëpërmjet angazhimit të përhershëm të ekspertëve të prokurimit, të cilët ndihmojnë dhe asistojnë zyrat e prokurimit që të zhvillojnë procedura të prokurimit në mënyrë sa më efikase dhe transparente,

Perveç kësaj përkrahja më e rëndësishme dhe e shënuar gjatë vitit 2020 të projektit TEAM, është përkrahja në finalizimin e dy moduleve dhe funksionaliteteve të reja të sistemit të prokurimit elektronik, moduli për menaxhim të kontratave dhe moduli për vlerësim të performancës së kontraktuesve, të cilat module janë bere tashmë pjesë e sistemit të prokurimit elektronik, duke e pasuruar prokurimin elektronik me vegla për administrim të implementimit të kontratave dhe vlerësim të performancës së implementimit të kontratave nga ana e kontraktuesve. Me vënien në përdorim të këtyre moduleve të reja, do të rritet dukshëm niveli i llogaridhënies në implementim të kontratave të nënshkruara nëpërmjet prokurimit publik dhe do ofrohet në kohë reale një pasqyrë e statusit të implementimit të të gjitha kontratave me vlerë mbi 1,000 Euro.

Sipas planeve të zhvillimit dhe implementimit të këtyre moduleve, ka qene e planifikuar që këto module të futen në përdorim në gjysmën e vitit 2020, mirëpo për shkak të rrethanave të reja të krijuar nga Covid 2019 procesi është shtyre për fillimin vitin 2021.

PERKRAHJA NGA BE-ja

Ne kuadër të procesit të reformës legjislativë një bashkëpunim shumë i rëndësishëm është bërë me projektin e BE-se për reformën legjislativë në Kosovë e cila është duke u implementuar nga kompania Gjermane GIZ. E gjithë përkrhja nga ky projekt ka qenë e fokusuar në draftimin e ligjit të ri për prokurim publik. Gjatë vitit 2020 edhe përkundër situatës së krutë nga Covid- 19 KRPP bashkë me grupin punës ka arritur të përgatisë draftin e parë për ligjin e ri për prokurimin publik në të cilin projekti i BE-se ka dhënë komentet e tij dhe të cilat kanë një rëndësi të veçantë për harmonizimin e plotë të legjislacionit tonë me ato të direktivave të BE-se.

REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË

